



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Skenografi-
Kostumografi”
ofruar nga
“ Universiteti i Arteve ”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Dorina Arapi

Dr. Sonia Jojic

Tetor/ 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në “Skenografi dhe Kostumografi” ofruar nga “Universiteti i Arteve”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Skenografi-Koreografi
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Skenografi - Kostumografi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 3, datë 05.02.1993
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 76, datë 12.02.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/ 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2024-2025: 15 PAE/ 5 PAK V.a 2023-2024: 15 PAE/6 PAK V.a 2022-2024: 14 PAE/5 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022-2023 – 10 studentë Viti akademik 2023-2024 – 8 studentë Viti akademik 2024-2025 – 7 studentë
19	Komente / të tjera:	




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vendimi Nr. 145, datë 10.3.2021, PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË UNIVERSITETIT TË ARTEVE SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E ARTEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, të Universitetit të Arteve (UART) vlerësohet si një hap pozitiv në mbështetje të arsimit dhe kulturës artistike në Shqipëri. Ky status paraqet disa aspekte pozitive, por gjithashtu reflekton kufizime dhe sfida në vlerësimin e arsimit të lartë me formim artistik.

Ky vendim reflekton faktin se mësimdhënia dhe kërkimi në art nuk ndjekin të njëjtat kritere si shkencat tradicionale. Specifikisht, Paragrafi i nenit nr. 2 përmban një njohje zyrtare të natyrës së veçantë të arsimit artistik. Dhënia e një statusi të veçantë për veprimtarinë e UART-it e dallon këtë universitet nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, duke e legjitimuar specifikën e prodhimit artistik si një formë e vlefshme e kërkimit dhe e performancës akademike.

Termi “aktivitet kërkimor artistik-shkencor” është i gjerë, i paqartë dhe evaziv, gjë që sjell pasiguri dhe mund të çojë në interpretime të ndryshme. Kjo e vështirëson më tej zbatimin, për shkak të mungesës së standardeve kombëtare për vlerësimin e artit si kërkim shkencor.

Paragrafi 2. ku cilësohet: “*Statusi i veçantë i jepet UART-it për trajtimin e veçantë për efekt mësimdhënieje, veprimtarie akademike, të organizimit akademik dhe administrativ, të organizimit të programeve të studimit, të organizimit të aktivitetit kërkimor artistik-shkencor, të njohjes së aktivitetit artistik si pjesë e aktivitetit shkencor, që shërben për të vlerësuar performancën akademike vjetore, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it e të legjislacionit në fuqi*”, njeh me të drejtë natyrën hibride të mësimdhënies dhe kërkimit në fushën e arteve dhe përpiqet të përshtasë strukturën ligjore ndaj fushave të artit. Megjithatë, ai mbetet shumë i përgjithshëm dhe pa mekanizma të qarta kontrolli dhe vlerësimi, gjë që krijon probleme nëse nuk shoqërohet me standarde të qarta dhe mekanizma vlerësimi objektiv.

Paragrafi 8. Pika.a, cilëson: “*UART-i gëzon status të veçantë lidhur me: a) organizimin e programeve të studimeve në tri cikle të njëpasnjëshme që përfundojnë me marrjen e diplomave ose të certifikatave përkatëse. Programet e studimeve në UART hartohen nga njësitë bazë dhe paraqiten për miratim në Senatin Akademik*”, përforcon autonominë dhe fleksibilitetin e Universitetit të Arteve në strukturimin e ofertës së tij akademike, duke i dhënë një autonomi akademike institucionit mbi hartimin e programeve nga njësitë bazë, çka i jep mundësi vetë komunitetit akademik të përcaktojë përmbajtjen e studimeve, në përputhje me zhvillimet artistike dhe kërkesat e tregut.

Por, pavarësisht këtij statusi të veçantë, që i përket Vendimit Nr. 145, datë 10.3.2021, PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË UNIVERSITETIT TË ARTEVE SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E ARTEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, si edhe duke u bazuar në vendimin e mëparshëm VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, UART, për vetë natyrën specifike që ka si institucion i lartë arsimor, paraqet vështirësi për t’ju përshtatur kërkesave specifike që kanë universitetet e tjera me orientim shkencor. Si rrjedhim, pa një kuadër të unifikuar kombëtar për arsimin artistik, të zgjeruar edhe të detajuar, të konceptuar specifikisht për këto programe studimi, vështirëson vlerësimin e tyre nga ekspertët e jashtëm, nga ASCAL, si edhe nga vetë

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

institucioni për tju përshtatur një qasjeje apo metodologjie që nuk është pjesë e kërkimit artistik.

Ky status i veçantë është një hap pozitiv, por do të ishte e dobishme që të përfshiheshin edhe udhëzime për harmonizimin e programve në UART, duke i bërë këto programe më të integrueshme globalisht, por edhe në mënyrë që kërkimi artistik të afrohet dhe të bashkëjetojë me atë shkencor. Mungesa e një kuadri të qartë për sigurimin e cilësisë dhe harmonizimin ndërinstytucional e bën këtë status të veçantë jo të qëndrueshëm, nëse nuk shoqërohet me disa mekanizma vlerësimi të standardizuar specifik për arsimin e lartë artistik të nivelit 6 të kualifikimit.

Programi Bachelor në “Skenografi dhe Kostumografi” ofrohet nga Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë në Universitetin e Arteve, i vetmi institucion publik i arsimit të lartë artistik në Shqipëri. Programi synon përgatitjen e skenografëve, kostumografëve dhe interdizajnerëve të aftë për të krijuar në teatër, opera, balet, film, televizion, modë e industri. Me një traditë që nis në vitin 1973, programi bazohet në konkurrim, ofron formim teorik e praktik bashkëkohor dhe vendos studentin në qendër të procesit mësimor. Qëllimi është zhvillimi i aftësive krijuese, profesionale dhe udhëheqëse në artin skenik dhe vizual.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vizita e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm në Fakulteti i Artit Skenik ku zhvillua gjatë dy ditëve, më 29 dhe 30 prill 2025. Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të angazhuar nga ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga: Dr.Sonia Jojic, Dr. Dorina Arapi.Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga koordinatori teknike e ASCAL, Msc. Alma Arapi. Aktivitetet nisën me një takim të brendshëm të grupit të vlerësimit, ku u diskutua mbi ecurinë dhe organizimin e vizitës, së bashku me Koordinatorin Teknik të ASCAL-it dhe Koordinatorin Institucional.

Më pas u zhvillua një takim me Dekanin e Fakulteti i Artit Skenik dhe Përgjegjës të Departamentit të Skenografi-Kstumografi, ku u trajtuan çështje që lidhen me strukturën, funksionimin dhe zhvillimet në departament. Vijoi takimi me përfaqësuesit e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm për të dy programet e studimit që ishin objekt i vlerësimit. Më tej, u mbajt një takim me stafin akademik të angazhuar në këto programe, si me ata me status efektiv, ashtu edhe me të angazhuarit me kontratë.

Pas një pushimi të shkurtër për drekë pune, grupi u takua me studentët e të dy programeve të studimit, për të dëgjuar opinionet dhe përvojat e tyre lidhur me procesin mësimor dhe përmbajtjen e programeve. Më vonë, u realizua një takim me përfaqësues të sektorëve përgjegjës për çështjet mësimore dhe kurrikulare, informimin dhe këshillimin e studentëve, si dhe me përfaqësues të rjetit të ish-studentëve (Alumni). Dita e parë u përmbyll me një vizitë në sekretarinë mësimore dhe një takim përmbyllës të shkurtër mes palëve pjesëmarrëse.

Në ditën e dytë, aktivitetet nisën me një tjetër takim të brendshëm të grupit të vlerësimit, për të përgatitur vijimin e punës. Më pas u zhvillua një takim me përfaqësuesit e Zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ku u diskutua mbi mekanizmat dhe dokumentacionin e brendshëm të cilësisë në institucion. Vizita vijoi me një takim me përfaqësues të Drejtorisë së

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, si dhe me Zyrën e Projekteve Artistike dhe Shkencore, ku u diskutua mbi përfshirjen e stafit dhe studentëve në projekte të ndryshme.

Në pjesën e dytë të ditës u realizua një vëzhgim i mjediseve të fakultetit, duke përfshirë auditorët, laboratorët, bibliotekën dhe shërbimet mbështetëse për studentët. Vizita u përmbyll me një takim me Përgjegjësin e Departamentit, ku u ndanë përshtypjet, u prezantuan gjetjet dhe u përmbyll procesi i vlerësimit për këtë fazë.

GVJ, pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft-raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentet në **FUSHËN II, STANDARDI II.3., KRITERI 2**, të paraqitura nga Universiteti i Arteve të Tiranës (UART), GVJ vlerëson masat e ndërmarra nga institucioni për të bërë ndryshimet e duhura në lidhje me planin mësimor.
2. Në lidhje me **FUSHËN II, STANDARDI II.4, KRITERI 4**, GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për përmirësimin dhe rishikimin e literaturës së sylllabuseve sipas kritereve të paracaktuara në ligjin e arsimit të lartë.
3. Në lidhje me **FUSHËN II, STANDARDI II.3, KONKLUZIONE PER STANDARDIN II.3**, GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për përmirësimin dhe rishikimin e literaturës së sylllabuseve
4. Në lidhje me **FUSHËN II, STANDARDI II.4, KRITERI 1, dhe KONKLUZIONE PER STANDARDIN II.4**, GVJ dakordëson për ndryshimin e vlerësimit, duke vendosur “plotësisht”.
5. Në lidhje me **FUSHËN III, STANDARDI III.1, KRITERI 6, dhe KONKLUZIONE PER STANDARDIN**, GVJ, dakordëson për ndryshimin e vlerësimit, duke vendosur “plotësisht”.

Më datë 24.09.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 23/28 Prot., Datë 24.09.2025, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlersimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 1582/1 Prot, Datë 01.10.2025.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Skenografi-Kostumografi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi Bachelor në “Skenografi-Kostumografi”, i ofruar nga Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamenti përkatës, është ndërtuar mbi një traditë akademike mbi 50 vjeçare dhe ofron një përgjigje konkrete ndaj kërkesave në rritje të tregut për profesionistë të kualifikuar në artin skenik dhe dizajnin dkenik. Struktura e programit thekson komponentin praktik dhe profesional, duke i përgatitur studentët të jenë skenografë dhe kostumografë të aftë për të kontribuar në zhvillimin e artit dhe kulturës. Kjo përgatitje e theksuar praktike, gjithashtu, synon të kontribuojë në përmirësimin e standardeve të edukimit artistik, duke ofruar një bazë të fortë për ata që duan të zhvillojnë karrierën e tyre në këtë fushë.</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm i programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi</i></p> <p><i>1.10_ Themelimi i Institutit të Lartë të Arteve.</i></p> <p><i>1.11_ Hapja e programit të parë Skenografi-Kostumografi.</i></p> <p><i>1.22_ Vendimi Nr.414, datë 12.11.1991 për fillimin e Akademisë së Arteve.</i></p> <p><i>1.13_ Krijimi UAR me VKM Nr. 234 date 23.03.2011.</i></p> <p><i>1.19_ Mbi miratimin e planit të strategjisë së UAR për vitet akademike 2018-2025</i></p> <p>http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=208&niveli=76</p>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” i Universitetit të Arteve të Tiranës (UART) është zhvilluar për t’u përshtatur me misionin dhe strategjitë e institucionit për avancimin e arsimit të lartë artistik dhe promovimin e vlerave kulturore. Ky program është në linjë me objektivat zhvillimore të UART dhe është pjesë e një vizioni më të gjerë institucional, që synon promovimin e dijes dhe performancën artistike.</p> <p><i>1.11_Hapja e programit të parë Skenografi-Kostumografi.</i> <i>1.19_Mbi miratimin e planit të strategjisë së UART për vitet akademike 2018-2025</i> http://ëëë.uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=208&niveli=76</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Skenografi dhe Kostumografi është i strukturuar në përputhje me dokumentet themeltare ligjore dhe strategjike të Universitetit të Arteve të Tiranës (UART). Ai është zhvilluar në kuadër të Planit Strategjik të UART për periudhën 2018–2025, i miratuar me vendim institucional, dhe synon orientimin afatgjatë të universitetit drejt një vizioni integruar në nivel kombëtar, evropian dhe global. Programi mbështetet në një bazë të gjerë ligjore dhe rregullore, duke përfshirë Statutin, Rregulloret e UART dhe FAS, si dhe aktet nënligjore të arsimit të lartë në Shqipëri.</p> <p><i>Evidenca</i> <i>1.19_Mbi miratimin e planit të strategjisë së UART për vitet akademike 2018-2025</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi është i integruar me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Arteve të Tiranës (UART) dhe është një pjesë thelbësore e Fakultetit të Artit Skenik (FAS). Institucioni zotëron përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit në fushën përkatëse. Ai disponon staf akademik të kualifikuar, infrastrukturë dhe burime didaktike që mbështesin zhvillimin profesional dhe akademik të studentëve, në përputhje me natyrën dhe objektivat e programit.</p> <p><i>Evidenca</i> <i>1.10_Themelimi i Institutit të Lartë të Arteve.</i> <i>1.11_Hapja e programit të parë Skenografi-Kostumografi.</i> <i>1.22_Vendimi Nr.414, datë 12.11.1991 për fillimin e Akademisë së Arteve.</i> <i>1.13_Krijimi UART me VKM Nr. 234 date 23.03.2011.</i></p>




	1.19__Mbi miratimin e planit të strategjisë së UART për vitet akademike 2018-2025			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p>Programi Bachelor në “Skenografi -Kostumografi” ofrohet nga Fakulteti i Artit Skenik (FAS) i Universitetit të Arteve të Tiranës (UART). Ky program është në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë, duke siguruar një formim të thelluar në fushën e arteve të performuara. Programi është kodifikuar dhe është në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, si dhe me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).</p> <p>1.23__SPECIFIKIMET DHE PERMBAJTJET E KODIFIKIMIT TE PROGRAMEVE TE STUDIMIT.</p> <p>1.24__Standardet Evropiane dhe Guidelines-ESG 2015.</p>			
Konkluzione	<p>Universiteti i Arteve i Tiranës (UART) ofron programe studimi të cilat janë hartuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me misionin dhe vizionin institucional, duke reflektuar angazhimin e tij për të promovuar arsimin e lartë cilësor në fushat e artit dhe kulturës. Këto programe janë të lidhura ngushtë me fushën akademike dhe shkencore të njësisë bazë përgjegjëse përkatëse, çka garanton përputhshmërinë mes ekspertizës disiplinore të stafit akademik dhe përmbajtjes kurrikulare.</p> <p>Në themel të filozofisë akademike të UART qëndron ruajtja dhe zhvillimi i identitetit kombëtar përmes artit, duke i dhënë përparësi trashëgimisë kulturore shqiptare, promovimit të vlerave artistike kombëtare dhe krijimtarisë bashkëkohore që ndërvepron me kontekstin global. Programet synojnë të edukojnë artistë, pedagogë dhe profesionistë të artit që jo vetëm zotërojnë njohuritë dhe aftësitë profesionale në fushat përkatëse, por edhe janë të përkushtuar ndaj promovimit dhe mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore dhe interesave kombëtare</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Personeli akademik i programit Bachelor në “Skenografi - Kostumografi” në Fakultetin e Artit Skenik gëzon status të veçantë sipas VKM Nr. 145, datë 10.03.2021. Çdo vit realizohet planifikimi i ngarkesës mësimore dhe analizohen performanca dhe nevojat për personel të ftuar. Programi mbështetet në bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet strukturave të brendshme të universitetit dhe synon një proces mësimor efikas, të mbështetur në indikatorë cilësie dhe takime periodike reflektuese.</p> <p>1.19_ Mbi miratimin e planit të strategjisë së UART për vitet akademike 2018-2025</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Universiteti i Arteve (UART) ka ndërtuar dhe vazhdon të zhvillojë marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe kërkimit artistik me një sërë institucionesh arsimore dhe artistike në Evropë dhe më gjerë. Këto bashkëpunime formalizohen shpesh përmes marrëveshjeve dypalëshe dhe projekteve të përbashkëta. UART ka nënshkruar marrëveshje me institucione, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Conservatoire National Supérieur de Musique et de Danse de Paris; • Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë; <p>si dhe me partnerë të tjerë ndërkombëtarë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Festivalin e Filmit “CINEDays” në Shkup; • Zhejiang Normal University në Kinë; • Universitetin e Arteve të Bukura “Mimar Sinan” në Turqi, <p>dhe institucione të tjera të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e artit dhe edukimit artistik. Gjithashtu, UART Universiteti i Arteve ka thelluar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes lidhjes së marrëveshjeve ndër-institucionale me nëntë institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, duke synuar promovimin e mobilitetit akademik në fusha të ndryshme të artit dhe teknologjive krijuese.</p> <p>Në kuadër të programit Erasmus+, janë vendosur marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione prestigjioze në Spanjë, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konservatorin e Lartë të Muzikës “Aldo” në Vigo; • Shkollën e Imazhit dhe Tingullit Audiovizual në Vigo; • Shkollën e Imazhit dhe Tingullit në La Korunja. <p>Këto marrëveshje synojnë të krijojnë mundësi konkrete për shkëmbime studentore dhe bashkëpunime akademike në fushat</p>



9


	<p>e muzikës, arteve pamore, dizajnit dhe teknologjive audiovizive, duke kontribuar në ndërkombëtarizimin e arsimit artistik dhe në rritjen e përvojës profesionale të studentëve.</p> <p>1.29_Marrëveshje bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>1.21_Marrëveshjet me partnerët UART</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>FAS/UART i ka dhënë një rëndësi të madhe bashkëpunimit me institucione të tjera për ofrimin e shërbimeve dhe mundësive për studentët e tij. Këto bashkëpunime janë realizuar përmes një sërë marrëveshjesh me institucione të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këshilli i Qarkut Tiranë, • Radio Televizioni Shqiptar, • Teatri Kombëtar, • Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, • Universiteti i Tiranës, • Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, • Shkolla Kombëtare Artistike "Jordan Misja", <p>për t'iu ofruar studentëve mundësinë të realizojnë projektet e tyre vjetore dhe të jenë në kontakt me profesionistë të fushës. Ky bashkëpunim ofron mundësinë për të ndjekur proceset krijuese në këto institucione, duke siguruar një laborator të vërtetë pune për studentët.</p> <p>Po ashtu, UART ka lidhur marrëveshje edhe në kuadër të "Paktit për Universitetin", duke përfshirë institucione si Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, Ministrinë e Kulturës dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, për të plotësuar nevojat e studentëve në realizimin e programeve të tyre.</p> <p>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm i programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi</p> <p>1.19_Mbi miratimin e planit të strategjisë së UART për vitet akademike 2018-2025</p> <p>1.21_Marrëveshjet me partnerët UART.</p> <p>4.6_Realizimi i Marrëveshjeve vjetore FAS 2021-2024.</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion</p>	<p>Njësia Bazë S&K, në bashkëpunim të ngushtë me Dekanatin e Fakultetit të Arteve Skenike, organizon mbledhje periodike për të vlerësuar ecurinë e programit të studimit dhe për të analizuar përfitimet që rrjedhin nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Këto takime synojnë të maksimizojnë ndikimin e bashkëpunimeve në zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve, si dhe të nxisin vazhdimësinë e tyre në mënyrë të qëndrueshme.</p>

<p>të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Përmes marrëveshjeve me institucionet kryesore të artit dhe kulturës, kryesisht në Tiranë, studentët përfitojnë nga mundësi të shumta për përfshirje aktive në jetën artistike. Ata marrin pjesë në aktivitete të ndryshme dhe realizojnë pjesë të provimeve praktike në mjedise të specializuara, përmes shfaqjeve të hapura për publikun.</p> <p>Bashkëpunimet me Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", Teatrin e Metropolit, si edhe me teatrot aktivë në qytete të tjera, përbëjnë një komponent kyç në këtë proces formimi.</p> <p><i>1.25_ Raportet e Vleresimit te Performances Vjetore per tre vite.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Universiteti i Arteve i Tiranës (UART) ndërton dhe kultivon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit, kërkimit dhe kulturës, me institucione publike dhe private, kompani dhe organizata të sektorit të industrisë kreative, si dhe me aktorë të rëndësishëm të jetës artistike dhe kulturore, brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëdhënie vendosen dhe zhvillohen në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit dhe të përforcimit të misionit të universitetit në edukimin artistik, në kërkimin shkencor e krijues dhe në përgatitjen e studentëve për tregun profesional.</p> <p>Bashkëpunimet synojnë krijimin e hapësirave për praktika profesionale dhe angazhime reale të studentëve në institucione të artit dhe kulturës, përfshirjen e profesionistëve të njohur të fushës në procesin mësimor, si dhe nxitjen e projekteve të përbashkëta kërkimore, prodhime artistike, festivale, ekspozita, botime dhe veprimtari të tjera kulturore. Nëpërmjet marrëveshjeve të mobilitetit, UART angazhohet gjithashtu në shkëmbime akademike me universitete partnere, duke ndihmuar studentët dhe stafin të zhvillojnë përvoja ndërkombëtare që thellojnë kompetencat e tyre dhe rrisin konkurrueshmërinë në kontekste më të gjera.</p> <p>Këto bashkëpunime përfaqësojnë një komponent strategjik në zhvillimin institucional të UART dhe dëshmojnë për përkushtimin e tij në integrimin e arsimit të lartë artistik me zhvillimet kulturore, ekonomike dhe shoqërore në nivel kombëtar dhe global.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>




standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Qëllimi i Programit të Studimit Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” është të sigurojë që të gjithë studentët të përfitojnë nga cilësia më e lartë në mësimdhënie, përmes plotësimit të nevojave të tyre, në përputhje me kërkesat e shoqërisë dhe tregut. Ky program është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS), me legjislacionin vendas dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Lëndët e programit janë kategorizuar në katër grupe kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëndë Bazë (përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme); • Lëndë Karakterizuese (përgatitje për disiplinën shkencore artistike); • Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese (nëndisiplinat dhe profilet); • Lëndë Plotësuese (grup-lëndë me zgjedhje, gjuhë e huaj, praktika profesionale); • Detyrime Përmbyllëse (Diploma, Tema Teorike dhe Projekti Artistik). <p>Në përfundim të studimeve, studentët e këtij programi grumbullojnë 180 ECTS gjatë tre viteve të studimit.</p> <p>Të gjitha lëndët janë të strukturuar sipas krediteve ECTS, në përputhje me Tabelën 1, të Shtojcës 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Për çdo lëndë është hartuar syllabusi përkatës.</p> <p><i>Programi është gjithashtu i publikuar në faqen online të universitetit</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e</p>	<p>Procesi mësimor bazohet në qasje student në qendër, duke theksuar zhvillimin individual të secilit student përmes metodave interaktive dhe të integruara, ku teoria ndërthuret ngushtë me praktikën. Programi ofron:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohuri të thelluara në skenografi dhe kostumografi, të mbështetura

shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikuesh me në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

nga module plotësuese që ndihmojnë në realizimin e projekteve profesionale.

- Formim krijues dhe konceptual përmes lëndëve të strukturuar që nxisin mendimin kritik, zhvillimin e ideve dhe kuptimin e parimeve të fushës.
- Metoda mësimore bashkëkohore që favorizojnë angazhimin aktiv të studentëve dhe ndërlidhjen e njohurive teorike me situata konkrete praktike.

Programi është i strukturuar në mënyrë që të nxisë zhvillimin e individualitetit artistik të studentëve në një mjedis krijues dhe bashkëpunues. Pjesë thelbësore e procesit formues është laborator praktik, ku studentët përfshihen aktivisht në projekte konkrete në lëndët profesionale të skenografisë dhe kostumografisë, duke përfunduar shprehitë e tyre teknike dhe krijuese.

Në këtë program zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë arsimin e lartë, duke përfshirë: VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar – për përbërësit e programeve të studimit; VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 – që i njeht Universitetit të Arteve statusin e veçantë si institucioni i vetëm publik në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë.

Lëndët e programit janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin përkatës, por me një shpërndarje të krediteve ECTS si më poshtë:

- **A Lënda kryesore –15 ECTS**
- **B Lënda karakterizuese –100 ECTS**
- **C Lëndë ndërdisiplinore/integruese –32 ECTS**
- **D Lëndë plotësuese –23 ECTS**
- **E Detyrat përfundimtare –10 ECTS**

Kategoria B përbën thelbin e formimit profesional, me lëndë karakterizuese që lidhen drejtpërdrejt me disipinën kryesore të studimit. Kjo kategori mbulon 100 ECTS, duke përfaqësuar pjesën më të madhe të ngarkesës mësimore dhe peshës formuese të programit. Shpërndarja e krediteve, lëndët speciale të kategorisë B kanë peshën më të madhe, pasi përfaqësojnë boshtin tematik dhe profesional të këtij programi studimi. Totali i lëndëve kryesore dhe lëndëve karakterizuese përbën shumën 71%, pothuajse në përputhshmëri me normativat (Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70% në rastin e programeve “Bachelor”).

Shih: VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË (Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; nr. 185, datë 25.3.2021; nr. 823, datë 28.12.2023) (I përditësuar)

Programi është gjithashtu i publikuar në faqen online të universitetit.

	<p>2.2__Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi.</p> <p>2.2__Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi-2.</p> <p>1.18__Rregullorja e programit të studimit Skenografi-Kostumografi</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, duke ndjekur udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MAS), ligjin në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi, dhe në fund të studimeve, studentët do të grumbullojnë gjithsej 180 ECTS për tre vitet e studimit.</p> <p>http://www.uart.edu.al/media/Plani%20M%C3%ABsimor%20Bsc%20Skenografi-Kostumografi.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Lëndët që përfshihen në kurrikulën e Programit të Studimit Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” janë të organizuara sipas kategorive A deri E, me raportin dhe specifikimet përkatëse të përcaktuara në Shtojcën I të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar. Këto kategori janë të ndara në mënyrë të tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A: 15 kredite për lëndët bazë, që përfshijnë përgatitje metodologjike dhe kulturore të përgjithshme; • Kategoria B: 100 kredite për lëndët karakterizuese, që janë thelbësore për disipinën shkencore dhe artistike; • Kategoria C: 32 kredite për lëndët ndërdisiplinore/integruese, që zhvillojnë shkathtësi të lidhura me fusha të tjera të dijes; • Kategoria D: 23 kredite për lëndët plotësuese, që përfshijnë praktikatat profesionale dhe gjuhët e huaja; • Kategoria E: 10 kredite për detyrimin përmbyllës, që përfshin diplomën, temën teorike dhe projektin artistik. <p>Kategoria B mbulon 100 ECTS, duke përfaqësuar pjesën më të madhe të ngarkesës mësimore dhe peshës formuese të programit. Shpërndarja e krediteve, lëndët speciale të kategorisë B kanë peshën më të madhe, pasi përfaqësojnë boshtin tematik dhe profesional të këtij programi studimi.</p> <p>Shih: VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË (Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; nr. 185, datë 25.3.2021; nr. 823, datë 28.12.2023) (I përditësuar)</p> <p><i>Programi është gjithashtu i publikuar në faqen online të universitetit</i></p> <p>Një kredit përfaqëson 25 orë mësimore punë të studentit, që përfshin orë</p>

	<p>leksionesh, seminare, ushtrime, projekte dhe aktivitete formuese, si dhe punë individuale përgatitore. Ngarkesa totale për një vit akademik është 60 kredite.</p> <p>Praktika profesionale është një pjesë e rëndësishme e programit dhe zhvillohet gjatë të 3 viteve akademike, për t'i aftësuar studentët në procesin e mësimdhënies. Praktika zhvillohet në mjediset e Universitetit të Arteve (UART), ku studentët realizojnë shfaqje të hapura për publikun. Praktika është e ndarë në tre vite, me 30 orë për vit dhe një total prej 90 orësh në vit.</p> <p>Në fund të çdo viti, studentët vlerësohen për zhvillimin e praktikës profesionale nga pedagogu i lëndës kryesore profesionale, dhe ky proces mundëson që studentët të fitojnë 6 kredite gjatë tre viteve të studimit (2 kredite për vit).</p> <p>http://www.uart.edu.al/media/Plani%20M%C3%ABsimor%20Bsc%20Skenografi-Kostumografi.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Universiteti i Arteve (UART) ofron mundësi për bursa dhe mbështetje financiare për studentët me aftësi të kufizuara dhe ata nga grupet "Rom/Balkano-Egjiptiane," Pranimi i studentëve bëhet përmes konkurseve të organizuara nga departamentet dhe miratuara nga Senati Akademik.</p> <p>http://www.uart.edu.al/index.php?id=1293 http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=292&niveli=83</p> <p>Njoftimet për bursa për studentët shpallen edhe në faqen zyrtare të universitetit, duke garantuar informim të gjerë dhe mundësi të barabarta për aplikim.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë</p>	<p>Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Departamenti i Interpretimit është i vetmi institucion që ofron program të ciklit të parë, Bachelor, në "Skenografi-Kostumografi".</p>

<p>studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në “Skenografi- Kostumografi” është kodifikuar dhe është i klasifikuar sipas VKM Nr. 310, datë 11/05/2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Ky program i takon kodit 63BA dhe është i regjistruar në fushën 02 — Arte dhe Shkenca Humane. Ky program i takon fushës së ngushtë të studimit Arte, ndërsa brenda kësaj fushë, ai është i kategorizuar si 0215 — Arte Muzikore dhe Performimi. Ky program ka 180 ECTS dhe ofrohet në gjuhën shqipe.</p> <p><i>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>NA</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Programi i studimit është konceptuar dhe organizuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë.</p>

	Struktura, përmbajtja, kurrikula, ngarkesa mësimore dhe rezultatet e të nxëniet janë të ndërtuara në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), duke garantuar transparencë, krahasueshmëri dhe transferueshmëri të krediteve sipas sistemit ECTS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>UART (Universiteti i Arteve të Shqipërisë) është një strukturë e integruar dhe e përbërë nga njësi kryesore që përbëhen nga njësi bazë dhe struktura të tjera ndihmëse me karakter akademik dhe administrativ. Ai vepron në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2014 dhe legjislacionin në fuqi, si dhe me përcaktimet statutores, për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij akademike.</p> <p>Në Fakultetin e Artit Skenik (FAS), programet e studimit ofrohen në përputhje me objektivat akademike dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Stafi akademik i Departamentit të Skenografisë dhe Koreografisë (S&K) përfshin një personel të kualifikuar, i cili përbëhet nga, Departamenti S&K: 11 pedagogë.</p> <p>Viti akademik 2024-2025 në total 17 pedagogë ku: Staf PAE – 11 pedagogë</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 Profesor/Doktor • 1 Profesor • 2 Profesorë të Asociuar/Doktor • 4 Profesorë të Asociuar • 3 Asistentë Lektorë <p>Staf PAK 6 pedagogë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 Profesor i Asociuar/ • 5 Asistentë Lektorë. <p>Staf PAE – 64 % Staf PAK - 36%</p> <p>Viti akademik 2023-2024 në total 24 pedagogë ku:</p>

Staf PAE – 11 pedagogë

- 1 Profesor/Doktor
- 1 Profesor
- 2 Profesorë të Asociuar/Doktor
- 4 Profesorë të Asociuar
- 3 Asistentë Lektorë

Staf PAK 13 pedagogë;

- 1 Profesor i Asociuar
- 12 Asistentë Lektorë

Staf PAE – 46%

Staf PAK - 54%

Viti akademik 2022-2023 në total 20 pedagogë ku:

Staf PAE – 11 pedagogë

- 1 Profesor/Doktor
- 1 Profesor
- 2 Profesorë të Asociuar/Doktor
- 5 Profesorë të Asociuar
- 2 Asistentë Lektorë

Staf PAK 9 pedagogë;

- 1 Profesor i Asociuar
- 8 Asistentë Lektorë

Staf PAE – 55%

Staf PAK - 45%

Përqindja mesatare për 3 vite akademike është mbuluar me PAE: 55% dhe PAK: 45%.

Viti Akademik 2022-2023 dhe 2023-2024 nuk kanë pasur përqindjet e stafit në përputhje me kërkesat ligjore. Në këto vite, PAE ka qenë më i ulët (45% dhe 46%), ndërsa PAK ka qenë më i lartë (55% dhe 54%).

Viti Akademik 2024-2025 tregon një përpjekje për balancim të përqindjeve, por përqindja e stafit PAE është ende më e lartë (64%), ndërsa PAK ka mbetur më i ulët (36%).

GVJ sugjeron që departamenti të sigurojë një balancim më të qëndrueshëm dhe të sigurojë një përqindje 70% staf PAE dhe

	<p>30% staf PAK për të përmbushur kërkesat ligjore.</p> <p>Në përputhje me këtë rekomandim, departamenti duhet të rishikojë strukturën e stafit dhe të bëjë përpjekje për të arritur një përqindje më të ekuilibruar për vitet e ardhshme, duke e rritur numrin e stafit PAE dhe duke siguruar që të mbetet brenda përqindjes 70% për këtë grup, dhe 30% për staf PAK.</p> <p>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm i programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi. Aneks Tabelat Skenografi-Kostumografi. 1.27_ Tabelat e stafit akademik FAS.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, pranë çdo njësie kryesore të Universitetit të Arteve funksionojnë struktura ndihmëse dhe mbështetëse me karakter akademik dhe administrativ. Këto struktura janë të përcaktuara në organigramën dhe në rregulloret përkatëse të secilës njësi. Personeli ndihmës akademik në Universitetin e Arteve përfshin dy kategori: atë me karakter mësimor-artistik/shkencor, i cili mbështet proceset mësimore dhe zhvillimin artistik, dhe atë me karakter administrativ, që garanton funksionimin logjistik dhe teknik të veprimtarive akademike në të gjitha nivelet e institucionit.</p> <p>4.5_ Listë e stafit ndihmës akademike</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në Departamentin e Skenografisë dhe Kostumografisë (S&K), programi i studimit është i organizuar në grupe mësimore të drejtuara nga përgjegjës të caktuar, të cilët mbikëqyrin procesin mësimor dhe sigurojnë përmbushjen e objektivave akademike. Menaxhimi dhe zhvillimi i përgjithshëm i programit dhe praktikave profesionale koordinohet nga Koordinatori i Programit të Studimit, i emëruar nga Dekani i Fakultetit të Arteve, i cili vepron gjithashtu si pedagog dhe kryetar grupi. Kjo strukturë ndihmon në ruajtjen e standardeve të larta akademike dhe përgatit studentët për karrierë profesionale dhe kërkime në fushat e skenografisë dhe kostumografisë.</p> <p>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbush në mënyrë të plotë kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për institucionet e arsimit të lartë, si dhe standardet e cilësisë të përcaktuara nga autoritetet përkatëse.</p>




	Njësia përgjegjëse garanton zhvillimin, zbatimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, duke siguruar përputhshmëri me fushën akademike përkatëse, përmbajtjen e kurrikulës, kompetencat e nevojshme të stafit akademik dhe cilësinë e procesit mësimor, në funksion të përmbushjes së objektivave të programit dhe përgatitjes së studentëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e artit dhe kulturës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Departamenti i Skenografisë dhe Koreografi (S&K), pjesë e Fakultetit të Artit Skenik në Universitetin e Arteve të Shqipërisë (UART), ofron programe studimi në të tre ciklet: Bachelor, Master dhe Doktoraturë. Në përputhje me udhëzimet e MASR dhe VKM nr. 145, datë 10.03.2021, ai mbetet institucioni i vetëm publik në vend për arsimin e lartë në fushën e arteve. Programi Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” është i strukturuar sipas rregulloreve përkatëse, përfshin objektiva formuese, planifikim semestral dhe përshkrime të detajuara të disiplinave, krediteve dhe aktiviteteve. Programi mbështetet në rregulloren mësimore dhe syllabus të hartuara në përputhje me aktet ligjore në fuqi, duke garantuar cilësi dhe zhvillim profesional të studentëve. Departamenti disponon kapacitetet e nevojshme për zbatimin e tij.</p> <p><i>2.2_Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi.</i></p> <p><i>2.2_Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi-2.</i></p> <p><i>1.18_Rregullorja e programit të studimit Skenografi-Kostumografi.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm	Programi Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” është ndërtuar mbi bazën e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 dhe legjislacionin përkatës.

<p>për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur mbi planin mësimor të programit, GVJ sugjeron rishikimin e kurrikulës në disa pika të rëndësishme:</i></p> <p><i>Në lëndët e kategorisë D, programi përfshin lëndën e gjuhës së huaj, konkretisht anglishten dhe frëngjishten, të cilat janë lëndë vjetore (anglishtja përfshin 4 semestra). Lënda Gjuhë e huaj është e detyrueshme. Në total, kjo lëndë zgjat 4 semestra, çka përbën një hapësirë të konsiderueshme në kurrikul.</i></p> <p><i>Duke pasur parasysh që bëhet fjalë për një program me karakter artistik dhe profesional, i cili synon përgatitjen sa më të plotë të studentëve në drejtim të zhvillimit të tyre profesional, GVJ rekomandon që lënda Gjuhë e huaj të kufizohet vetëm në dy semestra. Kjo do të krijonte hapësirë për përfshirjen e lëndëve të tjera me përmbajtje teorike-artistike dhe mbështetëse, të cilat ndihmojnë studentët në përvetësimin e plotë të kompetencave të parashikuara nga programi.</i></p> <p><i>Lëndë të tilla mund të jenë, për shembull:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Historia e tekstileve;</i> • <i>Menaxhimi i projekteve;</i> • <i>Njohja e materialeve;</i> • <i>Teknika të modelimit digjital,</i> • <i>Storefront design,</i> • <i>etj.</i> <p><i>Këto lëndë, të lidhura drejtpërdrejtë me formimin profesional dhe artistik, përbëjnë një vlerë të shtuar për zhvillimin e mëtejshëm të programit dhe për arritjen e objektivave të tij.</i></p> <p><i>Në përfundim, GVJ e konsideron të arsyeshme që lënda Gjuhë e huaj të përfshihet vetëm për dy semestra në planin mësimor dhe nënvizon domosdoshmërinë e një balancimi më të mirë përmes përfshirjes së lëndëve që forcojnë formimin profesional të studentëve.</i></p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm i programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi.</i> <i>Aneks Tabelat Skenografi-Kostumografi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me</p>	<p>Programi i studimit në “Skenografi-Koreografi”, i ofruar nga Departamenti Skenografi-Koreografi, Fakulteti i Arteve Skenike (S&K/FAS) në Universitetin e Arteve, ofron një kornizë të plotë akademike për formimin teorik dhe praktik të</p>

<p>kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>studentëve. Pranimi në program kërkon përfundimin e arsimit parauniversitar dhe përmbushjen e kritereve të vendosura nga Departamenti dhe Senati Akademik i UART. Programi zgjat tre vite dhe përfshin 180 kredite ECTS të ndara në lëndë bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore. Studentët mund të përfitojnë nga transferimi i krediteve nga programe të ngjashme brenda ose jashtë UART, sipas procedurave përkatëse.</p> <p>++1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” ofron një përgatitje të thelluar teorike dhe praktike për karrierën në art dhe dizajn. Ai përfshin syllabuse të detajuara, të cilat rishikohen çdo vit akademik. Studentët marrin pjesë në praktika profesionale, të cilat janë të lidhura ngushtë me fushën e skenografisë dhe kostumografisë, duke pasur mundësi për bashkëpunim me institucione të tjera. Syllabusi i secilës lëndë hartohet nga drejtuesi i lëndës, i cili është përgjegjës për organizimin e saj. Në rastin kur nuk ka një drejtues, me propozim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe me urdhër të Dekanit, syllabusi mund të hartohet nga një grup i personelit akademik me kohë të plotë, dhe më pas të konsultohet me grupin mësimor përkatës pranë departamentit.</p> <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, GVJ vëren se syllabuset e programit nuk përmbajnë të gjitha pikat sipas rregullave të përcaktuara. 99% e syllabuseve nuk përmbajnë literaturën dhe faqet përkatëse të librit për çdo javë të leksioneve. Syllabuset e gjuhëve të huaja, anglisht dhe frëngjisht, paraqesin temat në gjuhë të huaj, dhe syllabusi i gjuhës frënge është tërësisht në këtë gjuhë. GVJ rekomandon që syllabuset të jenë të përpiluara në gjuhën shqipe.</i></p> <p><i>Gjithashtu, GVJ vëren se disa syllabuse, edhe në pjesën e literaturës së detyrueshme dhe të rekomanduara, nuk përmbajnë titujt e librave apo të dhënat përkatëse bibliografike. GVJ rekomandon përmirësimin dhe unifikimin e të gjithë syllabuseve të programit.</i></p> <p>2.9_Rishikimi i Programeve të Studimit në vitet 2022-2024.</p> <p>2.2_Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi.</p> <p>2.2_Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi-2.</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e</p>	<p>Diskutimet dhe mbledhjet për përmirësimin e programit</p>

<p>programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>zhvillohen me pjesëmarrjen e stafit, studentëve dhe partnerëve të jashtëm, duke u bazuar në kërkesat e tregut dhe fushave përkatëse. Ndryshimet miratohen nga Senati Akademik dhe bëhen në përputhje me zhvillimet e industrisë dhe legjislacionin në fuqi, duke siguruar që programi të mbetet në hap me kohën dhe të ofrojë arsim të cilësisë së lartë.</p> <p><i>Bazuar në Evidenca 2.9 programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Skenografi-Kostumografi" nuk ka pasur sugjerime / rekomandime / ndryshime në lidhje me programin apo procesin mësimor akademik. Si rrjedhojë nuk është parë i nevojshëm rishikimi i Programeve të Studimit në Senatin Akademik, përgjatë këtyre viteve që ky program është futur në proces akreditimi.</i></p> <p>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm i programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ sugjeron rishikimin e kurrikulës duke propozuar që lënda Gjuhë e huaj, e cila aktualisht shtrihet në katër semestra, të reduktohet në dy semestra. Duke qenë se programi ka karakter artistik dhe profesional, hapësira e liruar në kurrikul mund të përdoret për lëndë që lidhen drejtpërdrejt me formimin profesional të studentëve, si historia e tekstileve, njohja e materialeve, teknika të modelimit digjital, menaxhimi i projekteve etj. Këto lëndë do të kontribuonin në përvetësimin më të plotë të kompetencave që kërkon programi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në "Skenografi-Kostumografi" ofron një formim të thelluar dhe të balancuar në dy disiplinat kryesore të fushës së artit, duke integruar elemente teorike dhe praktike. Strukturimi i programit përfshin një ndarje në semestra, ku studentët angazhohen në një kombinim të ligjëratave teorike dhe aktiviteteve praktike të drejtpërdrejta, përfshirë punë praktike në terren dhe mjedise të specializuara.</p>




punësimin e studentëve.	<p><i>Pavarësisht sa u shpreh më sipër, GVJ sugjeron rishikimin e kurrikulës në disa lëndë, duke parashikuar futjen e lëndëve mbështetëse që ndihmojnë studentët në përvetësimin e plotë të programit. Këto lëndë, të lidhura ngushtë me formimin profesional dhe artistik, përbëjnë një vlerë të shtuar për zhvillimin e programit dhe për arritjen e objektivave të tij.</i></p> <p>2.2_Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi.</p> <p>2.2_Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi-2.</p> <p>1.18_Rregullorja e programit të studimit Skenografi-Kostumografi.</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të nxënit.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” është i strukturuar me një ngarkesë totale prej 180 ECTS, të shpërndara në tre vite akademike, me 60 kredite për vit. Programi përfshin një ekuilibër mes teorisë dhe praktikës, bazuar sipas sistemin të Kartës së Bolonjës dhe mundëson vazhdimin në ciklet e studimeve të dyta dhe të treta.</p> <p>2.2_Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi.</p> <p>2.2_Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi-2.</p> <p>1.18_Rregullorja e programit të studimit Skenografi-Kostumografi.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Pavarësisht se struktura e programit, lëndët, dhe raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e programit të studimit, rekomandimi i GVJ për rishikimin e kurrikulës sugjeron përfshirjen e lëndëve mbështetëse që do të ndihmojnë studentët në përvetësimin e plotë të programit. Rishikimi i kurrikulës duhet të realizohet në bashkëpunim me ekspertë, duke krahasuar dhe shqyrtuar programe të ngjashme ndërkombëtare, për të siguruar që programi të përmbushë standardet dhe të ofrojë mundësi të mëdha për zhvillimin e studentëve në nivel ndërkombëtar.</p> <p>1.18_Rregullorja e programit të studimit Skenografi-Kostumografi</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” është i strukturuar në pesë kategori të veprimtarive formuese,</p>

<p>raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>nga A-ja deri te E-ja, duke ndarë formimin teorik dhe praktik.</p> <p>1.18 Rregullorja e programit të studimit Skenografi-Kostumografi.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve rishikohen çdo vit akademik nga pedagogu i lëndës, duke u konsultuar me anëtarët e departamentit dhe miratuar nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Bazuar në Evidenca 2.9 programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Skenografi-Kostumografi" nuk ka pasur sugjerime / rekomandime / ndryshime në lidhje me programin apo procesin mësimor akademik. Si rrjedhojë nuk është parë i nevojshëm rishikimi i Programeve të Studimit në Senatit Akademik, përgjatë këtyre viteve që ky program është futur në proces akreditimi.</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Rekomandimi i GVJ për rishikimin e kurrikulës përfshin përfshirjen e lëndëve mbështetëse që do të ndihmojnë studentët të përvetësojnë plotësisht programin, me fokus të veçantë në zhvillimin e aftësive profesionale dhe artistike. Këto lëndë do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së programit dhe do të ndihmojnë në realizimin e objektivave të tij. Përfitimet përfshijnë zhvillimin e aftësive praktike, rritjen e angazhimit të studentëve dhe forcimin e programit. Rishikimi i kurrikulës do të mundësojë mësimdhënie të integruar, e cila lidh teorinë me praktikën, dhe do të përgatisë studentët për kërkesat profesionale dhe sfidat që do të hasin në tregun global të punës.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p><i>Rekomandimi i GVJ për rishikimin e kurrikulës sugjeron përfshirjen e lëndëve mbështetëse për zhvillimin e aftësive profesionale dhe artistike të studentëve, duke lidhur teorinë me praktikën. Ky rishikim do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së programit, zhvillimin e aftësive praktike dhe përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale në tregun global të punës.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rekomandimi i GVJ për rishikimin e kurrikulës sugjeron përfshirjen e lëndëve mbështetëse për zhvillimin e aftësive profesionale dhe artistike të studentëve, duke lidhur teorinë me praktikën. Ky rishikim do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së programit, zhvillimin e aftësive praktike dhe përgatitjen e</i></p>

	<i>studentëve për sfidat profesionale në tregun global të punës..</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë ka treguar një angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e programit të studimit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës. Edhe pse përmirësimet janë mbështetur nga vlerësimet periodike të studentëve, siç u përmend më sipër, departamenti duhet të forcojë më tej kontaktet e vazhdueshme me aktorë të ndryshëm të fushës dhe me ekspertë të jashtëm, në funksion të një rishikimi të vazhdueshëm dhe cilësor të programit. Kjo do të ndihmojë në harmonizimin më të mirë të përmbajtjes akademike me nevojat aktuale të kohës.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Fakulteti i Artit Skenik (FAS) dhe Departamenti i Skenografi Koreografisë (S&K) mban kontakte të rregullta me alumni-t. Aktivitetet e organizuara nga FAS për alumni-t janë një mundësi për të mbledhur të dhëna mbi ecurinë e punësimit të diplomuarve dhe arritjet e tyre, duke krijuar kështu një lidhje të drejtpërdrejtë me tregun e punës. <i>5.14_Statistika e Fas për numrin e studentëve dhe të Diplomuarve 2022-2025</i> <i>5.18_Raportimi Vjetor ALUMNI</i> <i>6.6_Komunikim me ish alumni.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në	Fakulteti i Artit Skenik (FAS), konkretisht Departamenti i Skenografisë-Koreografisë (S&K), ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, me synimin për të forcuar lidhjet ndër-institucionale dhe për të ofruar mundësi të zgjeruara për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve. Partnerët kryesorë të këtyre bashkëpunimeve përfshijnë:

<p>bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Këshillin e Qarkut Tiranë; • Radio Televizionin Shqiptar; • Teatrin Kombëtar; • Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit; • Universitetin e Tiranës; • Universitetin “Aleksandër Moisiu” të Durrësit; • Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës. <p>Një hap thelbësor në konsolidimin e këtyre marrëdhënieve ka qenë miratimi i “Paktit për Universitetin”, një dokument strategjik që synon përmirësimin e kushteve të studimit dhe zgjerimin e mundësive për zhvillim akademik. Marrëveshjet e realizuara në vijim të këtij pakti kanë krijuar kushte më të mira për studentët, duke kontribuar në ofrimin e një arsimit cilësor, praktik dhe të orientuar drejt tregut të punës.</p> <p>3.16_Korrespondenca me partnerët në shërbimet e shfaqjeve të studentëve.</p> <p>4.6_Realizimi i Marrëveshjeve vjetore FAS 2021-2024.</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p>Universiteti i Arteve i Tiranës (UART) angazhohet fuqishëm për të inkurajuar përfshirjen aktive të studentëve, partnerëve akademikë dhe profesionalë, rrjeteve kulturore dhe organizmave relevantë vendas dhe ndërkombëtarë në procesin e hartimit, zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit. Përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit institucional, konsultimeve të rregullta dhe përfshirjes në strukturat vendimmarrëse, UART siguron që zëri i studentëve dhe aktorëve të tjerë kyç të dëgjohej dhe të integrohet në vendimmarrje.</p> <p>Kjo qasje gjithëpërfshirëse ndihmon që programet e studimit të jenë në harmoni me objektivat artistike, akademike dhe profesionale të universitetit, duke reflektuar nevojat aktuale të tregut të punës në fushën e artit dhe kulturës, si dhe standardet bashkëkohore ndërkombëtare. Përfshirja e gjerë e aktorëve kontribuon në rritjen e cilësisë së arsimit, në realizimin me sukses të qëllimeve të programeve dhe në formimin e artistëve dhe profesionistëve të aftë dhe të përgjegjshëm ndaj sfidave të komunitetit kulturor dhe shoqërisë në përgjithësi.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 1751 770 1834">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="770 1751 978 1834">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="978 1751 1176 1834">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1176 1751 1402 1834">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="576 1834 770 1874"></td> <td data-bbox="770 1834 978 1874"></td> <td data-bbox="978 1834 1176 1874"></td> <td data-bbox="1176 1834 1402 1874">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						




Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit dhe Planin Mësimor, si dhe me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore në fuqi, format e mësimdhënies për programin e studimit Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Leksionet 2. Seminarët 3. Detyrat e kursit 4. Kolokiumi 5. Puna individuale 6. Detyrat praktike 7. Projekti artistik 8. Provimet 9. Praktika profesionale 10. Teza/Diplomimi <p>Mësimdhënia në këtë program është një proces ndërlidhës mes stafit akademik dhe studentëve, i cili zhvillohet përmes një qasjeje të drejtpërdrejtë dhe individuale, duke synuar zhvillimin e aftësive kritike dhe krijuese të studentëve. Gjatë këtij procesi, përdoren teknika dhe metoda mësimdhënies që largohen nga format tradicionale, duke ofruar mundësi për një mësimdhënie dhe mësim nxënie më aktive dhe të fokusuar në zhvillimin e pavarur të studentëve.</p> <p><i>1.18_Rregullorja e programit të studimit Skenografi-Kostumografi.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik është përgjegjës për zhvillimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e dijeve të studentëve, duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme pedagogjike dhe metodologjike që nxisin përfshirjen aktive të tyre.</p> <p>Pedagogët orientojnë studentët drejt metodave bashkëkohore të të nxënit dhe të mësimdhënies, duke forcuar lidhjen ndërmjet praktikës artistike, kërkimit shkencor dhe zhvillimit profesional. Një nga metodat më efikase për këtë qëllim është</p>

	<p>organizimi i projekteve artistike të përbashkëta që përfshijnë studentë dhe pedagogë, si brenda ashtu edhe jashtë Fakultetit të Arteve të Skenës (FAS).</p> <p><i>Mësimdhënia fokusohet në zhvillimin individual të studentëve përmes detyrave të personalizuar, ushtrimeve praktike dhe konsultimeve jashtë orarit mësimor. Një praktikë efektive është mësimdhënia e bazuar në projekte, ku studentët zhvillojnë një koncept kostumografik për një shfaqje. Ky proces përfshin analizën e tekstit, krijimin e skicave, përzgjedhjen e materialeve dhe prezantimin final të modeleve, duke simuluar praktikën reale profesionale dhe duke zhvilluar të menduarit kritik dhe krijues.</i></p> <p><i>Procesi mësimor ndërlidhet ngushtësisht me disiplinat e tjera skenike përmes bashkëpunimit me studentët e regjizurës, aktrimit dhe skenografisë, duke theksuar rolin e kostumit si pjesë përbërëse e një tërësie skenike. Gjithashtu, vëmendje i kushtohet inkorporimit të kostumografisë, veçanërisht në kontekste teatrale dhe etnografike.</i></p> <p>2.10_Dosja e repertorit të shfaqjeve të pedagogëve, studentët aktualë dhe ish studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.</p>	<p>Përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor në Departamentin e Skenografisë-Koreografisë (S&K) të Fakultetit të Artit Skenik (FAS) përfshin inkurajimin e pjesëmarrjes në trajnime, dhe aktivitete artistike që zhvillojnë aftësitë pedagogjike dhe mësimdhënëse. Staf i akademik vazhdimisht përmirëson kompetencat e tij përmes metodave të diversifikuara, të përshtatura me objektivat e programit dhe rezultatet e pritshme. Programi përfshin leksione, ushtrime dhe projekte, duke inkurajuar gjithashtu mësimin jashtë auditorit.</p> <p><i>Universiteti i Arteve i ofron mbështetje stafit akademik nëpërmjet aplikimit të projekteve të ndryshme, ku përmes këtyre të fundit stafi mund të adresojë, të hulumtojë dhe zhvillojë karrierën artistike, përmes përfutimit të projekteve të aplikuara. Një shembull i tillë është aplikimi i projektit "Zbërthimi i teknikave të realizimit të veshjeve dhe bizhuterive tradicionale shkodrane" nga stafi i departamentit.</i></p> <p><u>http://ëëë.uart.edu.al/index.php?id=1317</u></p> <p>Thirrjet për projekte shpallen gjithashtu në faqen zyrtare të universitetit, duke siguruar transparencë dhe akses të barabartë për të gjithë stafin akademik të interesuar.</p> <p>Gjithashtu, sipas raportit vjetor 2023-2024, stafi akademik ka</p>

	<p>zhvilluar aktivitete artistike të shumta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • “Rituali i Jetës” – Punëtori muzikore dhe performancë, në bashkëpunim me PARTNER-ART24, Universitetin e Arteve Tiranë (UART) dhe Conservatori Superior de Música de les Illes Balears, Spanjë (CSM de Balears). • Musical “Sofra Tiranase” – Blackbox, UART, Maj 2024. • Opera “Samson dhe Dalila” – Projekt i realizuar në bashkëpunim me institucionet përkatëse artistike. • Ekspozita Personale/ Ekspozita Kolektive • Sfilata “XIERHOFF” – Hotel Rogner, Tiranë. • Sfilata “XHUBLETA INSPIRED” – Pallati i Brigadave, Tiranë. • “Burra pa gra” – Përfshirje në projekt teatror me fokus në temat sociale dhe gjinore. • “Përfshirja e të rinjve në trashëgiminë kulturore” – Projekt në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. • “Albania Event Production” – Spektakël artistik në kuadër të Elite Dance Festival, Tiranë. • “Youth University 2” – Workshop dhe shfaqje me të rinjtë, në bashkëpunim me ART24. • “Cast pa kohë” – Projekt artistik në bashkëpunim me Fakultetin e Arteve të Skenës (FAS). • “Hapësira ndërmjet vetes dhe të tjerëve” – Vepër koreografike e udhëhequr nga vetë artistja, realizuar sipas planit strategjik <p>4.34_Projekte të aplikuara 4.21_Kërkesa e pedagogut për leje për krijimtari apo aktivitet</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron</p>	<p>Personeli akademik i Programit të Studimit Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” ka një përbërje të larmishme dhe të kualifikuar, e cila përfshin individë me tituj shkencorë të avancuar dhe eksperiencë të pasur profesionale në fushën e artit dhe dizajnit skenik. Ata janë të angazhuar në aktivitete artistike dhe profesionale jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar, duke kontribuar në zhvillimin e artit skenik dhe kostumografisë në një shkallë globale.</p> <p>Për të siguruar një përvojë të lartë akademike, ky staf përdor një kombinim metodash tradicionale dhe bashkëkohore mësimdhënieje. Metodatat tradicionale përfshijnë mbështetje të drejtpërdrejtë, mësimdhënie në formë leksionesh dhe seminare, si dhe angazhimin e studentëve në aktivitete praktike dhe projekte që pasqyrojnë realitetin profesional. Në anën tjetër,</p>

<p>udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>metodat bashkëkohore përfshijnë përdorimin e teknologjisë dhe mësimdhënies interaktive, duke përfshirë platforma online, mjetet digjitale dhe simulime të proceseve krijuese. Këto metoda bashkëkohore janë të rëndësishme për zhvillimin e aftësive teknike dhe kreative të studentëve, duke i mundësuar atyre të angazhohen më thellë në materialet mësimore dhe të krijojnë lidhje të drejtpërdrejta me zhvillimet aktuale të industrisë së artit.</p> <p>Një aspekt i rëndësishëm i këtij programi është që departamenti është gjithmonë i gatshëm për të përmirësuar dhe përditësuar metodat e mësimdhënies. Ky përmirësim i vazhdueshëm bëhet nëpërmjet një procesi reflektimi dhe vlerësimi periodik, që ndihmon në përshtatjen e mësimdhënies me kërkesat e studentëve dhe zhvillimet e fushës. Gjithashtu, një element thelbësor është angazhimi i studentëve në këtë proces përmirësimi. Ata janë të ftuar të japin komente dhe sugjerime mbi metodat dhe materialet mësimore, duke krijuar kështu një mjedis mësimor të hapur dhe bashkëpunues. Ky bashkëpunim ndërmjet stafit akademik dhe studentëve siguron një përvojë të pasur, të plotë dhe dinamike për të gjithë ata që janë pjesë e programit.</p> <p>2.10_Dosja e repertorit të shfaqjeve të pedagogëve, studentët aktualë dhe ish studentët.</p> <p>6.5_Foto nga procesi i mesimdhënies në auditor, provim, diploma.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Departamenti i S&K në UART përmirëson cilësinë e mësimdhënies duke analizuar ecurinë e procesit mësimor në fund të vitit akademik, duke përdorur sugjerimet e stafit dhe anketimet e studentëve. Ky proces përfshin mbulimin me materiale studimore, kontrole të vazhdueshëm, provime përfundimtare dhe praktika profesionale. Personeli akademik mbështetet nga personel ndihmës dhe administrativ në realizimin e aktiviteteve praktike dhe mbajtjen e laboratorëve.</p> <p>3.7_Të nga pyetësoret e studentëve në FAS.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të</p>	<p>Strukturat kryesore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në UART janë Departamentet, të cilat bashkëpunojnë me sektorët përkatës dhe ndjekin politika për rritjen e kualifikimit të stafit akademik.</p> <p>Pavarësisht se institucioni ka disa marrëveshje bashkëpunimi</p>

<p>mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>me institucione ndërkombëtare, është evident se në nivel fakulteti dhe departamenti nuk janë zhvilluar mobilitete të stafit dhe studentëve gjatë këtyre tre viteve akademike. Ky është një faktor që ka ndikuar në mundësitë për përfitimin e përvojave ndërkombëtare dhe ndarjen e njohurive dhe praktikave më të mira nga institucione të tjera të njohura ndërkombëtarisht. Mobilitetet akademike, si për stafin ashtu edhe për studentët, janë një mundësi e rëndësishme për shkëmbimin e dijes, zhvillimin e aftësive profesionale dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në këtë kontekst, mungesa e mobiliteteve mund të përbëjë një pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të programit dhe për rritjen e angazhimit të komunitetit akademik me zhvillimet globale në fushën e skenografisë dhe kostumografisë.</p> <p>Gjithashtu, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitat në institucion, rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare 3 • Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore) 45 orë mësimore Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit -3 nga ESAD Seville • Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime 0 • Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. 0 <p>Bazuar në këto të dhëna, stafi pedagogjik ka bërë përpjekje për t'u përfshirë në projekte, por në rastet e mobiliteteve, institucioni ka pasur rolin e pritësit</p> <p>Tabela 20 Të dhëna për Bashkëpunime shkencore në rang Fakulteti/programi studimi në kuadër të Bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Pavarësisht marrëveshjeve me institucione ndërkombëtare, gjatë tre viteve të fundit nuk janë realizuar mobilitete të stafit apo studentëve në nivel fakulteti dhe departamenti. Kjo ka kufizuar mundësitë për përfitimin e përvojave ndërkombëtare dhe shkëmbimin e praktikave të mira. Mungesa e mobiliteteve përbën një pengesë për zhvillimin e programit dhe për angazhimin me zhvillimet globale në fushën e skenografisë dhe</p>




	<i>kostumografisë. Edhe pse stafi pedagogjik ka bërë përpjekje për përfshirje në projekte, roli i institucionit ka qenë kryesisht si pritës në rastet e mobiliteteve...</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Në këtë program studimi, ashtu si në të gjitha programet e ciklit të parë dhe të dytë në UART, vlerësimi i njohurive të studentëve bëhet sipas sistemit shqiptar me notë maksimale 10 dhe kaluese nga nota 5 e lart. Vlerësimi është i vazhdueshëm dhe ka për qëllim nxitjen e studimit gjatë gjithë vitit, objektivitetin në ndarjen e pikëve dhe monitorimin e përvetësimit të lëndës. Format e provimeve përfshijnë: provime të lëndëve speciale, me shkrim në klasë, me shkrim e gojë, si dhe në grup për realizimin e veprave artistike. Mënyra e vlerësimit dhe pesha e çdo elementi përcaktohen në planin dhe programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve në fillim të semestrit.</p> <p><i>1.15_ Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.</i></p> <p><i>1.16_ VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregulloreve të Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.</i></p> <p>1.17_ RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO.</p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Programi i studimit dhe lëndët përbërëse janë të publikuara në faqen zyrtare të UART. Në fillim të çdo semestri, studentët njihen me syllabuset që përmbajnë temat, literaturën, format e vlerësimit dhe detajet përkatëse. Një përmbledhje e shkurtër e lëndëve dhe programit gjendet në faqen e dedikuar për çdo program, ndërsa syllabuset janë të aksesueshme pranë S&K. Në javën e orientimit, studentët informohen për ndjekjen e programit, detyrimet dhe procesin e diplomimit. Vlerësimi përfundimtar përfshin të gjitha komponentët e lëndës – artistik, teorik, praktik – dhe pesha e tyre përcaktohet në planin mësimor dhe programin e lëndës.</p>

	<p><i>1.15_ Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.</i></p> <p><i>1.16_ VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregulloreve të Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.</i></p> <p>1.17_ RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Procesi mësimor në programin Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” në UART përfshin një shumëllojshmëri formash mësimi dhe kontrolli të dijes, të harmonizuara sipas planit mësimor dhe programeve të lëndëve. Mësimi zhvillohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, projekteve artistike, praktikave profesionale dhe konsultimeve. Kontrolli i dijes realizohet me provime me shkrim, me gojë, vlerësim projektesh dhe kombinime të këtyre formave. Gjithashtu përfshihen provime të formimit artistik dhe mbrojtje diplomash individuale apo në grup.</p> <p><i>1.15_ Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.</i></p> <p><i>1.16_ VSA 35 datë 07.12.2021 për Miratimin e Rregulloreve të Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.</i></p> <p>1.17_ RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në Universitetin e Arteve (UART), përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies është përgjegjësi e njësive bazë akademike, të cilat analizojnë ecurinë e mësimdhënies për çdo pedagog në përfundim të vitit akademik. Ky proces mbështetet në sugjerimet e stafit pedagogjik, anketimet e studentëve dhe të dhënat e sekretarive mësimore. Stafi akademik paraqet problematikat e hasura dhe sugjeron përmirësime në përmbajtjen e lëndëve në përfundim të çdo semestri. Departamenti i Skenografisë-Koreografisë analizon të gjitha aspektet e procesit mësimor, përfshirë materialet studimore, vlerësimet e vazhdueshme dhe provimet përfundimtare, praktikat profesionale dhe punimet e diplomave. Në rast nevojë, propozohen ndryshime për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Po ashtu, mbikëqyren standardet e përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve dhe dokumentacionit të programeve. Ky proces asiston nga personel ndihmës akademik</p>




	<p>dhe administrativ, i cili kontribuon në regjistrimin video të provimeve dhe projekteve, realizimin e elementeve skenike dhe kostumeve, përzgjedhjen e rekuizitave dhe mirëmbajtjen e laboratorëve, si dhe ndihmon në zhvillimin e praktikave të diplomave.</p> <p><i>1.15_ Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.</i></p> <p>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Programi Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” në Universitetin e Arteve të Tiranës ofron një qasje fleksibël dhe të avancuar, që përshtatet me kërkesat e tregut të punës dhe objektivat formuese. Mësimdhënia zhvillohet në grupe të vogla, duke inkurajuar komunikim të hapur dhe bashkëpunim, dhe duke kombinuar metodat tradicionale dhe bashkëkohore. Programi fokusohet në zhvillimin e aftësive praktike dhe teorike, duke nxitur pavarësinë dhe kreativitetin te studentët.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti i Arteve i Tiranës (UART) ka hartuar dhe miratuar rregullore dhe procedura të qarta dhe transparente për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijes dhe aftësive profesionale të studentëve në të gjitha programet e studimit. Këto dokumente janë në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe standardet e arsimit të lartë, dhe kanë për qëllim sigurimin e një procesi vlerësimi objektiv, të drejtë dhe me cilësi të lartë, që reflekton në mënyrë të saktë përgatitjen akademike dhe artistike të studentëve.</i></p> <p><i>UART garanton zbatimin rigoroz të këtyre rregulloreve dhe procedurave në të gjitha fazat e procesit mësimor, duke përdorur metoda të ndryshme të vlerësimit, si provime teorike,</i></p>

	<i>detyra praktike, projekte artistike, prezantime dhe kritika, të përshtatura me fushat specifike të artit. Për më tepër, universiteti siguron trajnime dhe mbështetje të vazhdueshme për stafin akademik për metodologjitë e vlerësimit, duke përmirësuar kështu cilësinë dhe besueshmërinë e proceseve të vlerësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Vlerësimi i studentit në programin Bachelor në “Skenografi - Kostumografi” bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës së ndjekjes së studimeve dhe është i përcaktuar qartë në syllabus-in e çdo lënde. Komponentët e vlerësimit përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pjesëmarrjen aktive në mësim (10%), • punën e pavarur krijuese (20%), • detyrat e kursit (10%), • projektet e kursit (30%) • provimin përfundimtar (30%). <p>Provimet zhvillohen në përputhje me strukturën mësimore të vitit akademik në tre sezona: dimër, verë dhe vjeshtë. Datat e provimeve propozohen nga njësitë bazë, miratohen nga Dekani dhe shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të sezonit. Studentët duhet të shlyejnë të gjitha detyrimet përpara sezonit të provimeve dhe nuk lejohen të shlyejnë detyrime gjatë vetë sezonit të provimeve.</p> <p>1.15_ Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.</p> <p>1.17_ RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Për shkak të natyrës specifike të programeve të studimit në Universitetin e Arteve, provimet në Fakultetin e Artit Skenik zhvillohen kryesisht në auditor dhe nuk përdoren sisteme elektronike të kontrollit. Provimet për lëndët profesionale zhvillohen në forma alternative, si ekspozita apo shfaqje, ku vlerësimi bazohet në performancën dhe vizualitetin. Ndërsa provimet teorike organizohen të sekretuara.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>1.15_Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.</p> <p>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në Universitetin e Arteve, për programin Bachelor në “Skenografi-Kostumografi”, rregullorja e studimeve përcakton qartë sistemin e vlerësimit dhe format e provimeve, që janë të shprehura në planin mësimor të secilës lëndë dhe në syllabus, duke përfshirë informacionin mbi peshën e elementeve të vlerësimit. Studentët informohen për këto elemente që në fillim të semestrit. Provimet me shkrim vlerësohen me pikë, të cilat pastaj konvertohen në nota. Tezat për lëndët teorike hartohen nga titullarët e lëndëve dhe miratohen nga përgjegjësit e Njësisë Bazë. Provimet janë të sekretuara dhe përfshijnë kushtet e kalimit dhe mundësinë për përmirësimin e notës, si dhe dokumentet që vlerësojnë arritjet e studentëve.</p> <p>1.15_Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.</p> <p>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit akademik, që përfshin elementët e përcaktuar në programin e lëndës dhe mbrojtjen e diplomës, është një mekanizëm kyç për zhvillimin e aftësive teorike dhe praktike të studentëve. Procesi i mësimdhënies në Fakultetin e Artit Skenik mbështetet në VKM Nr.145 dhe përfshin konsultime të rregullta pas çdo ore mësimi për përmirësimin e arritjeve në fushën e interpretimit. Analiza e punës së studentëve dhe e aktiviteteve artistike bëhet pas çdo semestri dhe vitit kalendarik, duke evidentuar arritjet dhe mangësitë dhe duke përcaktuar detyra për përmirësimin në semestrin pasardhës. Ky proces siguron një monitorim të vazhdueshëm dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë akademike.</p> <p>1.15_Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.</p> <p>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk</p>	<p>Provimet mbahen nën mbikëqyrjen e komisionit të provimit dhe personelit administrativ për nevoja logjistike. Pajisjet elektronike janë të ndaluara dhe çdo formë plagjiature</p>

<p>lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>ndëshkohet me përjashtim nga provimi dhe vlerësim negativ. Puna teorike verifikohet përmes një platforme anti-plagjiaturë të administruar nga Sektori i TI në bashkëpunim me RASH http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=585&niveli=81 http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=963&niveli=82</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi i provimeve realizohet nga komisioni përkatës, i cili përbëhet nga titullari i lëndës dhe staf akademik. Rezultatet e provimeve jepen jo më vonë se 5 ditë pune pas mbajtjes së provimit dhe bazohen në meritë. Sistemi PITAGORA menaxhon studimet dhe kurrikulën dhe ndihmon në lidhjen mes pedagogëve, studentëve dhe institucionit. Studentët mund të ankimojnë rezultatet brenda 5 ditëve. Rezultati përfundimtar bëhet i njohur menjëherë pas përditësimit në sistemin PITAGORA http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=585&niveli=81</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas rregullores, studentit i ofrohet mundësia për përmirësimin e notave brenda tre viteve të ciklit të parë të studimit. Studentët mund të përmirësojnë deri në 3 nota, duke hyrë në riprovim vetëm në sezonin përkatës (vjeshtor për vitet e para, veror për vitin e tretë). Kërkesa për përmirësim duhet të bëhet brenda një jave pas provimit, dhe nëse studentin nuk paraqitet, nota e mëparshme mbetet në fuqi. Për modulet me disa disiplina, përmirësimi realizohet për të gjithë modulin.</p>




<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtën të ankohet në rast se ka shkelje të rregullave procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nëse është bërë një vlerësim i padrejtë për përgjigjen e tij ose për performancën artistike që ka realizuar. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim brenda një afati prej 24 orësh nga shpallja e rezultatit në Dekanat. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë komisionin e provimit dhe studentin për sqarime. Pas shqyrtimit të çështjes, Dekani merr një vendim përkatës brenda 3 ditëve. Vendimi i Dekanit do të përcaktojë nëse kërkesa e studentit është e drejtë apo jo. Nëse ankesa është e drejtë, Dekani shpall pavlefshmëri të rezultatit të vlerësimit dhe mund të caktojë një provim të ri për studentin, me komision të njëjtë ose të ri, dhe me një përfaqësues të caktuar nga Dekani. Ky provim i ri do të realizohet brenda 5 ditëve nga përfundimi i sezonit të provimeve të përkatës.</p> <p>1.15 Rregullore mesimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART.</p> <p>1.17 RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti i Arteve i Tiranës (UART) siguron një proces vlerësimi të drejtë, objektiv dhe transparent, i bazuar në meritën individuale të çdo studenti. Vlerësimi realizohet në përputhje me rregulloret përkatëse dhe duke respektuar parimet e barazisë dhe të trajtimit të paanshëm.</i></p> <p><i>Në funksion të transparencës dhe mbrojtjes së të drejtave të studentëve, institucioni ka të përcaktuar qartë procedurat për paraqitjen dhe trajtimin e ankimeve në lidhje me rezultatet e vlerësimit. Studentëve u garantohet e drejta për të kërkuar rishikim të vlerësimit, në përputhje me afatet dhe mekanizmat e parashikuar në aktet nënligjore të institucionit. Kjo siguron besueshmëri dhe integritet të procesit mësimor dhe vlerësues.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i</p>	<p>Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Skenografi-</p>

Adresa: “Ruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Kostumografi” ka si objektiv ofrimin e njohurive dhe aftësive artistike, teorike dhe praktike në fushën e Skenografisë dhe Kostumografisë, për të gjitha zhanret e skenës teatrale dhe televizive. Ky program ofrohet me 180 kredite dhe ka një zgjatje normale prej 3 vjetësh. Pas përfundimit të këtij cikli studimi, studenti pajiset me diplomën "Bachelor në Skenografi-Kostumografi".</p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi laboratorët që shërbenin për zhvillimin e lëndëve praktike dhe profesionale të programit. Në programin e Kostumografisë, një nga faktorët kyç që ndihmon zhvillimin dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës dhe kërkesat profesionale është infrastruktura e specializuar, që përfshin makineritë, materialet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e projekteve të kostumeve. Ky aspekt është esencial për të ofruar një eksperiencë të plotë dhe të realizueshme për studentët në procesin e mësimdhënies dhe praktika profesionale.</i></p> <p>1.15_Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.</p> <p>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p> <p>Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit në “Skenografi-Kostumografi” nuk ka si objektiv kryesor zhvillimin e aftësive teknologjike të studentëve në fushën e Teknologjisë së Informacionit (TI); megjithatë, në kuadër të lëndëve me zgjedhje, është e përfshirë lënda "Aftësim dhe Informacion", e cila ka si qëllim futjen e studentëve në botën e informacionit elektronik. Gjithashtu, lënda "Skenografi dhe Kostumografi Televizive" është pjesë e detyrueshme e programit dhe fokusohet në njohjen e studentëve me teknikat dhe teknologjinë e informacionit që përdoren në televizion. Kjo lëndë realizohet në vitin e tretë të studimeve.</p> <p>Sa i përket zhvillimit të aftësive humane, sociale dhe të komunikimit, programi dhe format e vlerësimit të dijeve përballë audiencës (përmes provimeve dhe performancës artistike) kontribuojnë në zhvillimin e aftësive komunikative të studentëve dhe nxisin proceset e të menduarit kritik. Ky aspekt ka si synim formimin e studentëve si individë të përgjegjshëm, të vetëdijshëm për rolin e tyre shoqëror dhe profesional.</p> <p>2.2_Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi.</p>

	<p>2.2_Kurrikula e Programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi-2.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësimi i studentëve monitorohen përmes vlerësimit të vazhduar dhe provimeve përfundimtare, duke përfshirë praktikat profesionale dhe mbrojtjen e temave teorike. Vlerësimi fokusohet në zhvillimin e njohurive dhe aktiviteteve profesionale, mbështet diskutimet dhe punën në grup, dhe inkurajon idetë inovative. Pas çdo semestri, pedagogët analizojnë punën e klasës për të përmirësuar performancën, dhe raporti vjetor i aktivitetit akademik dhe financiar paraqitet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.</p> <p>1.15_Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.</p> <p>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Ky program studimi synon zhvillimin e kompetencave të përgjithshme dhe të transferueshme në fushën e artit dhe edukimit artistik, të cilat janë thelbësore për krijimin e performancave efektive dhe qëndrimeve krijuese. Praktika profesionale mundëson përdorimin e njohurive të fituara në një kontekst praktik. Studentët zhvillojnë praktikë në institucione arsimore dhe kulturore sipas marrëveshjeve të arritura. Një element kyç i këtij programi është puna në grupe, ku studentët bashkëpunojnë me të tjerë dhe zhvillojnë aftësi si arsyetimi profesional, zgjidhja e problemeve dhe aftësi interpersonale. Pedagogët krijojnë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e ideve inovative dhe shkencore. Programi mbështet projekte artistike dhe inkurajon mobilitetin dhe bashkëpunimin me institucione dhe homologë të tjerë të arsimit të lartë dhe artit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit -3 nga ESAD Seville <p>Tabela 20 Të dhëna për Bashkëpunime shkencore në rang Fakulteti/programi studimi në kuadër të Bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, rezultojnë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për punime shkencore individuale të studentëve: Nuk ka asnjë student të aktivizuar. • Për projekte shkencore në nivel departamenti: Nuk ka

	<p>asnjë student të aktivizuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për projekte shkencore në nivel fakulteti: Nuk ka asnjë student të aktivizuar. • Për projekte shkencore në bashkëpunim me institucione të tjera: Nuk ka asnjë student të aktivizuar. <p><i>Në këtë rast, GVJ rekomandon aktivizimin e studentëve në projekte dhe punime shkencore.</i></p> <p>Evidenca. Aktivizimi i studentëve në aktivitete shkencore në tri vitet e fundit (Tabela 22)</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas raportit vjetor 2023-2024, stafi akademik ka zhvilluar aktivitete artistike të shumta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • “Rituali i Jetës” – Punëtori muzikore dhe performancë, në bashkëpunim me PARTNER-ART24, Universitetin e Arteve Tiranë (UART) dhe Conservatori Superior de Música de les Illes Balears, Spanjë (CSM de Balears). • Musical “Sofra Tiranase” – Blackbox, UART, Maj 2024. • Opera “Samson dhe Dalila” – Projekt i realizuar në bashkëpunim me institucionet përkatëse artistike. • Ekspozita Personale/ Ekspozita Kolektive • Sfilata “XIERHOFF” – Hotel Rogner, Tiranë. • Sfilata “XHUBLETA INSPIRED” – Pallati i Brigadave, Tiranë. • “Burra pa gra” – Përfshirje në projekt teatror me fokus në temat sociale dhe gjinore. • “Përfshirja e të rinjve në trashëgiminë kulturore” – Projekt në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. • “Albania Event Production” – Spektakël artistik në kuadër të Elite Dance Festival, Tiranë. • “Youth University 2” – Ëorkshop dhe shfaqje me të rinjtë, në bashkëpunim me ART24. • “Cast pa kohë” – Projekt artistik në bashkëpunim me Fakultetin e Arteve të Skenës (FAS). • “Hapësira ndërmjet vetes dhe të tjerëve” – Vepër koreografike e udhëhequr nga vetë artistja, realizuar sipas planit strategjik <p><i>Por në bazë të dokumentacionit, të dhënat tregojnë një mungesë të pjesëmarrjes së stafit në aktivitete shkencore:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare 3</i> • <i>Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime 0</i>




	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. 0 <p>Tabela 20 Të dhëna për Bashkëpunime shkencore në rang Fakulteti/programi studimi në kuadër të Bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit</p> <p><i>Pavarësisht kësaj, institucioni është duke u angazhuar me organizimin e konferencës ndërkombëtare shkencore, që është planifikuar në muajin qershor.</i></p> <p><i>Konferenca ndërkombëtare që do të zhvillohet në muajin qershor nga UART përbën një mundësi të shkëlqyer për Universitetin e Arteve (UART) për të forcuar pozitën e tij në fushën e kërkimit artistik dhe shkencor. Kjo ngjarje ka potencialin të shërbejë si një urë e rëndësishme për përfshirjen e stafit akademik në një rrugëtim më të thelluar drejt zhvillimit të kërkimit, duke nxitur dialog dhe bashkëpunim ndërkombëtar në fushat e arteve dhe shkencës. Konferenca do të ofrojë mundësi për të ndarë përvoja dhe për të krijuar rrjete profesionale me individë dhe institucione ndërkombëtare. Ky shkëmbim mund të sjellë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta si punëtori, projekte kërkimore, dhe organizimin e aktiviteteve artistike që mund të kontribuojnë në rritjen e pranisë ndërkombëtare të UART.</i></p> <p>Vizita në institucion</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti i Arteve i Tiranës (UART) ka ngritur struktura të posaçme në nivel institucional dhe njësisht akademike që kanë për detyrë promovimin dhe mbështetjen e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në të gjitha programet e studimit. Këto struktura funksionojnë në përputhje me politikat e brendshme të sigurimit të cilësisë dhe me kuadrin rregullator kombëtar për arsimin e lartë.</i></p> <p><i>Ndër strukturat kryesore përfshihen Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, njësi të brendshme cilësie në fakultete dhe departamente, si dhe grupet e vetëvlerësimit të ngritura për çdo program studimi. Këto struktura monitorojnë ecurinë e procesit mësimor, nxisin reflektimin pedagogjik, analizojnë të dhënat nga vlerësimet e studentëve dhe sugjerojnë masa konkrete për përmirësim.</i></p> <p><i>Nëpërmjet veprimtarisë së tyre, universiteti synon të rrisë ndërgjegjësimin institucional për cilësinë, të forcojë kulturën e përmirësimit të vazhdueshëm dhe të sigurojë që mësimdhënia dhe mësimnxënia të zhvillohen në përputhje me standardet akademike dhe nevojat e studentëve.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Programi përcakton kërkesat për diplomimin e studentëve, duke përfshirë modalitetet dhe mbrojtjen e diplomës. Studentët duhet të kenë përfunduar të gjitha detyrimet dhe të kenë shlyer kreditet dhe detyrimet financiare para mbrojtjes së diplomës. Provimi i diplomës përfshin një koncert si mbrojtje artistike, ku studentët përgatisin aranzhime dhe realizojnë provat me ansamblin. Të gjitha procedurat organizohen dhe mbikëqyren nga pedagogu udhëheqës.</p> <p>Procesi i diplomës është një fazë e rëndësishme dhe delikate për çdo program studimi, dhe në rastin e programit të studimit në Skenografi dhe Kostumografi, ky proces mbështetet në një rrjet të gjerë bashkëpunimi me institucione të ndryshme, si dhe me alumni të programit.</p> <p>Një nga aspektet kyçe të suksesit të këtij programi është bashkëpunimi i ngushtë me institucione kulturore, arsimore dhe artistike, si dhe me sektorët e tjerë të tregut të punës.</p> <p>Një aspekt tjetër i rëndësishëm është bashkëpunimi dhe sinergia brenda departamentit të Skenografisë-Koreografisë. Këto aspekte u panë gjatë vizitës në institucion dhe diskutimet me stafin dhe studentët.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> <p><i>1.15 Rregullore mesimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART.</i></p> <p><i>1.17 RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve</p>	<p>Institucioni ka hartuar manualin e studentit, i cili është hartuar për t'u ardhur në ndihmë studentëve në orientimin e tyre sa më të qartë dhe efikas në kryerjen e studimeve në Universitetin e Arteve. Në këtë manual janë përfshirë elementët kryesorë të detyrimeve dhe të drejtave të studentit, disa njohuri bazë dhe informacion i nevojshëm për ndjekjen e studimeve në ciklin e parë dhe të dytë. Manuali shpjegon se çfarë janë kreditet dhe përse shërbejnë ato, si duhet t'i përdorë studenti këto kredite dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>përmbyllëse.</p>	<p>si mund t'i transferojë ato në një institucion tjetër të Arsimit të Lartë, brenda apo jashtë Shqipërisë; Kreditet që i duhen një studenti për të kaluar vitin e parë, të dytë, të tretë, të ciklit të parë të studimeve dhe sa kredite i duhen për të hyrë në ciklin e dytë të studimeve Master; Frekuentimi i detyrueshëm dhe penalizimi me 25% të mungesave. Manuali shpjegon rastet kur studenti nuk mund të hyjë në provim dhe si mund të përmirësojë notën e marrë një herë. Në këtë manual jepen njohuri për mënyrën se si mund të bëhet i mundur ndërrimi i programit të studimit apo pezullimi i tij, a largimi i përkohshëm.</p> <p>3.10 Manuali i mësimdhënies</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Neni 32 i Rregullores së Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Asaj Mësimore të Departamentit të Skenografisë dhe Koreografisë pranë Fakultetit të Artit Skenik parashikon se provimet zhvillohen sipas orarit të shpallur një javë para fillimit të sezonit, me orë, datë dhe ambient të caktuar nga Departamenti. Komisioni i provimit përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë ose të ftuar për atë vit dhe ka të paktën tre anëtarë. Ai drejtohet nga titullari i lëndës me titullin akademik më të lartë, ndërsa kryetari i komisionit emërohet nga Dekani me propozim të Përgjegjësit të Departamentit. Rregullat e tjera për zhvillimin e provimeve dhe kalimin e vitit përcaktohen në rregulloren e ciklit të studimit dhe të programit përkatës.</p> <p>1.17_RREGULLORE DHE VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME DHE DEP. SKENO_KOREO.PDF</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i</p>	<p>Studenti dhe pedagogu përcaktojnë afate për programin e diplomës, ku studenti udhëhiqet metodologjikisht dhe konsultohet rregullisht për ecurinë e punës. Programi i diplomës miratohet nga pedagogu dhe studenti ndjek një grafik konsultimesh të detyrueshëm.</p> <p>1.15_Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.</p> <p>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>

plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve ofron ambiente të specializuara dhe të pajisura me teknologji bashkëkohore për zhvillimin e veprimtarive mësimore dhe artistike, si klasat artistike, biblioteka, fonoteka, salla koncertesh dhe pajisje audio-video. Ndër hapësirat kryesore janë salla "Black Box", një sallë moderne teatrore me infrastrukturë profesionale për ndriçim dhe fonie; Galeria FAB, një hapësirë ekspozimi e hapur për publikun në ambientet e Fakultetit të Arteve të Bukura; Salla Multimediale, e pajisur me programe të specializuara për fushat e artit dhe në shërbim të studentëve dhe studiuesve; si dhe Amfiteatri i universitetit, një hapësirë shumëfunktionale në ambient të hapur që shërben për plotësimin e programit mësimor dhe organizimin e aktiviteteve artistike.</p> <p><i>Vizita në institucion</i> http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=18&niveli=104 http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=788&niveli=102 http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=292&niveli=83</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Fakulteti Skenik organizon tre sezone për mbrojtjen e diplomës: në verë, në vjeshtë dhe në dimër. Pas përfundimit të provimit, kryetari i komisionit mbledh anëtarët për të vlerësuar punimin, ku secili anëtar jep pikët përkatëse dhe e nënshkruan vlerësimin. Të gjitha vlerësimet dokumentohen dhe i bashkëngjiten procesverbalit ku regjistrohet nota përfundimtare. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative ose nuk paraqitet në sezonin e parë, ai ka të drejtë të ripërsërisë procesin brenda afateve të përcaktuara nga rregullorja e studimeve.</p> <p><i>Për vitin akademik 2022-2023, janë diplomuar 10 studentë në ciklin e parë të studimeve Bachelor në programin "Skenografi-Kostumografi". Aktualisht, këta studentë po vazhdojnë studimet në ciklin e dytë (Master) në Universitetin e Arteve. Në lidhje me punësimin, studentët e diplomuar nuk rezultojnë të jenë punësuar.</i></p> <p><i>Të Dhëna për Diplomimin dhe Punësimin e Studentëve (Tabela 23)</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentët që plotësojnë kriteret dhe mbrojnë me sukses diplomën pajisen me diplomë dhe suplementin përkatës, të miratuar nga Senati Akademik dhe të</p>

<p>suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>regjistruar nga QSHA me numër unik identifikimi. Universiteti ruan kopje të dokumentacionit dhe ofron informacion sipas kërkesës, përfshirë listën e notave dhe shkallën e përbushjes së standardeve akademike.</p> <p><i>3.10_Manuali i mësimdhënies</i> <i>5.15_Rregullorja e Sektorit Mësimor UART</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Në Universitetin e Arteve, dokumentimi i aktivitetit akademik të studentëve kryhet në formatet fizike dhe elektronike, të menaxhuara nga njësitë përgjegjëse gjatë studimeve. Programet mësimore hartohen dhe menaxhohen sipas kuadrit ligjor dhe rregulloreve të institucionit. Arkiva-Protokolli mban përgjegjësinë për ruajtjen e dokumentacionit dhe korrespondencës, ndërsa çdo fakultet ka arkivën e vet. Sekretaria Mësimore siguron katalogimin dhe ruajtjen e të dhënave në një server qendror, gjithashtu duke arkivuar dokumentet elektronike në formate të mbrojtura si CD dhe DVD, për të garantuar sigurinë dhe aksesin në informacionin akademik.</p> <p><i>1.15_Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.</i> <i>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</i> <i>3.10_Manuali i mësimdhënies</i> <i>5.15_Rregullorja e Sektorit Mësimor UART.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti i Arteve i Tiranës (UART) ndjek një procedurë të qartë, të standardizuar dhe të dokumentuar për përbushjen e detyrimeve përfundimtare të studentëve në kuadër të programit të studimit. Kjo procedurë përfshin verifikimin e plotësimit të krediteve të kërkuara, realizimin e praktikës profesionale (kur parashikohet), dorëzimin dhe mbrojtjen e punimit të diplomës apo projektit përfundimtar, si dhe përbushjen e detyrimeve administrative dhe financiare ndaj institucionit.</i></p> <p><i>Pas përbushjes së këtyre detyrimeve, studenti pajiset me dokumentacionin përkatës, përfshirë diplomën, suplementin e diplomës dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm që dëshmon përfundimin me sukses të programit të studimit dhe të drejtën për të ushtruar profesionin përkatës. Procedura zhvillohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me rregulloret e brendshme të institucionit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Gjatë vizitës së zhvilluar nga GVJ dhe sipas raportit përkatës, u konstatua se stafi akademik i angazhuar në procesin e mësimdhënies në programin Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” i përmbahet kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 dhe akteve nënligjore: VKM nr. 29, datë 10.09.2018; VKM nr. 329, datë 12.04.2017; VKM nr. 145, datë 10.03.2021, si dhe Kodit të Punës.</p> <p>Në raport theksohet gjithashtu se, për shkak të natyrës së veçantë të programit, departamenti vlerëson përvojën artistike dhe shkencore të stafit në përputhje me lëndët që mbulojnë. Pedagogët e lëndës kryesore “Skenografi dhe Kostumografi” kanë një karrierë të konsoliduar në artin skenik. Pjesa më e madhe e stafit është alumni i FAS/UART, me përvojë të spikatur dhe të rikthyer në auditore si kontribuues në formimin profesional të studentëve.</p> <p>Struktura e stafit akademik të Departamentit të Skenografisë dhe Kostumografisë (S&K):</p> <p>Gjatë vitit akademik 2024–2025, Departamenti i Skenografisë-Koreografisë angazhon gjithsej 17 pedagogë, të ndarë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Staf me angazhim të përhershëm (PAE): 11 pedagogë (64%) <ul style="list-style-type: none"> ○ 1 Profesor Doktor ○ 1 Profesor ○ 2 Profesorë të Asociuar, Doktorë ○ 4 Profesorë të Asociuar

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

- 3 Asistentë Lektorë (nga të cilët 2 janë në proces doktorature)
- Staf me angazhim të përkohshëm (PAK): 6 pedagogë (36%)
 - 1 Profesor i Asociuar
 - 1 Doktor
 - 4 Asistentë Lektorë

Të dhëna për vitet e mëparshme:

- Viti akademik 2023–2024: 24 pedagogë
 - Staf PAE: 46%
 - Staf PAK: 54%
- Viti akademik 2022–2023: 20 pedagogë
 - Staf PAE: 55%
 - Staf PAK: 45%

Mesatarja trevjeçare rezulton:

- Staf PAE: 55%
- Staf PAK: 45%

	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Asc.Dr	1	-	1	-	1	-
Prof.Asoc.	4	-	4	-	4	-
Prof.Dr	2		1	-	1	-
Prof	1	-	2	-	2	-
Dr	3	-	3	-	3	-
Msc	3	5	4	6	4	5
Total	14	5	15	6	15	5

Sipas raportit të GVJ dhe analizës së strukturës së stafit për tre vitet e fundit, vihet re se në vitin 2022–2023 dhe 2023–2024, përqindja e stafit PAE ka qenë nën pragun ligjor të kërkuar prej 70%, përkatësisht në nivelin 45% dhe 46%, ndërkohë që PAK ka tejkaluar përqindjen e lejuar.

Vihet re se UART dhe Departamenti i Skenografisë - Koreografisë për vitin akademik 2024–2025 reflekton një përmirësim në drejtim të balancimit, me rritje të përqindjes së stafit PAE në 64%, megjithatë ende nuk përmbushet plotësisht kërkesa ligjore për 70% staf PAE dhe 30% PAK. GVJ sygjeron që departamenti të ndërmarrë hapa konkretë për të rishikuar strukturën e stafit dhe për të siguruar një raport të qëndrueshëm dhe në përputhje me kuadrin ligjor, duke synuar arritjen e përqindjes 70% PAE dhe 30% PAK.

	<p>në vitet në vijim.</p> <p>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm i programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi.</p> <p>Tabelat 2 Departamenti i Skenografi - Kostumografi dhe Koreografi.</p>																				
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Gjithashtu nga tabela 4 rezulton që ngarkesa mësimore për PAE në disa raste shkon deri 420 orë mësimore, çfarë mund të rishikohet në një balancim më të mirë të ngarkesës mesimore të personelit të angazhuar me këtë program studimi.</p> <p>Në lidhje me planin mësimor të lidhur me personelin akademik përkatës me ngarkesën mësimore (orë), të dhënat vijojnë si:</p> <table border="1" data-bbox="544 685 1386 1021"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>2930</td> <td>2420</td> <td>510</td> <td>82.59% / 17.41%</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>2945</td> <td>2615</td> <td>450</td> <td>84.71% / 15.28%</td> </tr> <tr> <td>2024-2025</td> <td>2690</td> <td>2210</td> <td>480</td> <td>82.15% / 17.84%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Programi i studimit “Skenografi-Kostumografi” në UART paraqet një strukturë të qëndrueshme të mbulimit të ngarkesës mësimore nga stafi akademik me marrëdhënie të qëndrueshme pune (PAE), me përqindje që varion nga 82.15% në 84.71% përgjatë tre viteve të fundit, duke tejkaluar kërkesën minimale ligjore prej 70%. Pjesëmarrja e stafit me kontratë të përkohshme (PAK) mbetet në kufijtë 15–18%, duke mundësuar përfshirjen e ekspertizës specifike nga fusha praktike. Kjo shpërndarje reflekton përputhshmëri të plotë me kuadrin ligjor dhe angazhim për cilësi të lartë në procesin mësimor..</p> <p>Referenca RVB / Tabela 12.1; 12.2; 12.3</p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2022-2023	2930	2420	510	82.59% / 17.41%	2023-2024	2945	2615	450	84.71% / 15.28%	2024-2025	2690	2210	480	82.15% / 17.84%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2022-2023	2930	2420	510	82.59% / 17.41%																	
2023-2024	2945	2615	450	84.71% / 15.28%																	
2024-2025	2690	2210	480	82.15% / 17.84%																	
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën</p>	<p>Referuar RVB-së dhe gjithashtu vizitës në institucion, GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin Bachelor në “Skenografi-Kostumografi”. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” ka nënshkruar kontratat me UA sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu, edhe stafi akademik me kontratë, për vetë specifikën e këtij programi, përtej zbatimit të kontratave për staf akademik me kohë të pjesshme, i</p>																				

<p>e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>kushtohet vëmendje për të pasur një bashkëpunim sa më të gjatë. Duke qenë se është një entitet shtetëror, UART është i detyruar të paguajë dhe të deklarojë kërkesat ligjore.</p> <p>4.2_ Kontratat e punes se stafit akademik me kohe te plote dhe kohe te pjesshme.</p> <p>4.3_ stë-pagesat janë të lidhura me stafin akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Pas takimit në institucion, GVJ u njoh me procedurat e ndjekura për punësimin e stafit akademik në Universitetin e Arteve, të cilat zhvillohen nëpërmjet konkursit të hapur dhe transparent, siç përcaktohet në nenin 92 të Rregullores së brendshme. Nevojat për staf lindin në nivel departamenti dhe kriteret shtesë miratohen nga Rektori. Për programin “Skenografi-Kostumografi”, vlerësohet edhe veprimtaria artistike e kandidatëve. Rektori miraton listën vjetore të stafit me kohë të përkohshme, bazuar në propozimet e departamenteve dhe planet mësimore. Në bazë të VKM nr. 145, UART ka të drejtë të ftojë artistë dhe studiues vendas apo të huaj për angazhime afatshkurtra akademike dhe kërkimore.</p> <p>Referanca: RVB Takimi ne Institucion 4.4_Dosja e praktikave të punësimit</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh nga afër me organizimin akademik dhe administrativ të UART, i cili funksionon në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. U evidentua se struktura e brendshme mbështetet në një rrjet njësisht ndihmëse akademike dhe administrative, që luajnë rol thelbësor në mbështetjen e procesit mësimor dhe praktik. Këto njësi angazhohen në zhvillimin e praktikave laboratorike, ndjekjen e punëve praktike dhe diplomave, mirëmbajtjen e infrastrukturës teknike si dhe ofrimin e mbështetjes për stafin dhe studentët.</p> <p>Në mënyrë të veçantë, stafi mësimor i specializuar në fushat e skenografisë dhe kostumografisë orienton studentët në përdorimin e materialeve dhe pajisjeve profesionale, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive krijuese dhe teknike të nevojshme për tregun e punës. Kjo përfshirje, në kombinim me infrastrukturën përkatëse, u ofron studentëve një bazë solide për të përmbushur standardet e industrisë artistike dhe për të ndërtuar një profil konkurrues në praktikë. Strukturat përbërëse përfshijnë sekretarinë e fakultetit, specialistët e kurrikulës dhe teknikët e laboratorëve, të cilët</p>

	<p>mbështesin funksionimin efikas të programit.</p> <p>http://uart.edu.al/media/PERSONELI%20NDIHMES%20AKADEMIK%20FAS%202025.pdf</p> <p>Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, GVJ vëren se jo të gjitha dosjet e stafit pedagogjik, të përhershëm dhe të jashtëm, janë të përditësuara dhe të kompletuara me dokumentacionin përkatës. Vërehet gjithashtu se CV-të e disa anëtarëve të stafit nuk pasqyrojnë në mënyrë të plotë aktivitetet e tyre artistike dhe kërkimore.</p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ rekomandon që njësi përgjegjëse dhe departamenti përkatës të marrin masat e nevojshme për përditësimin e CV-ve të stafit akademik dhe plotësimin e dosjeve individuale për çdo pedagog.</i></p> <p><i>Vizita ne institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e</p>	<p>Gjatë takimit në institucion dhe pyetjeve ndaj stafit, u vu re se praktika profesionale është pjesë e rëndësishme dhe karakteristike e programit Bachelor në Skenografi – Kostumografi, e përcaktuar edhe nga statusi i veçantë i institucioni. Praktikrat drejtohen dhe mbikëqyren nga personeli akademik me kohë të plotë, sipas marrëveshjeve vjetore të punës dhe pasqyrohen në ngarkesat e mësimdhënies së pedagogëve. Praktikrat zhvillohen në ambientet e FAS/UART ose në partnerë lokalë si Teatri Kombëtar, Teatri Eksperimental, Teatri i Operës dhe Baletit, Teatri i Kukullave, si dhe në televizione dhe platforma mediatike në Tiranë. Në çdo rast, stafi akademik e mbikëqyr procesin.</p>

<p>studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Referanca: RVB Takimi ne Institucion Evidencës 2.1.1 "Plani Mësimor Bachelor në Skenografi dhe Kostumografi Evidenca 1.30 "Aktivitetet e realizuara në institucionet partnere në 3 vitet e fundit"</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Sipas RVB-së dhe takimeve në institucion, GVJ është njohur që praktika profesionale është pjesë shumë e rëndësishme e programit Bachelor në "Skenografi-Kostumografi". Kjo praktikë është e përcaktuar edhe në statusin e veçantë të institucionit. Për këtë arsye, drejtimi i praktikave bëhet nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas marrëveshjeve vjetore dhe është i përfshirë në ngarkesat e tyre të punës. Praktikant zhvillohen ose në ambientet e fakultetit ose në partnerët tanë, si Teatri Kombëtar, Teatri Eksperimental, Teatri i Operës dhe Baletit, Teatri i Kukullave, dhe televizionet e Tiranës. Gjatë gjithë kohës, praktikant mbikëqyren nga stafi akademik. Studentët përfitojnë shumë nga përvoja e artistëve dhe stafit të institucioneve pritëse, ndërsa bashkëpunimi ndihmon që të fitojnë njohuri praktike dhe të avancuara. Kjo është pjesë e planit mësimor dhe përkushtimit të stafit për të ofruar një program cilësor.</p> <p>Referanca: RVB Takimi ne Institucion Evidenca 1.30 "Aktivitetet e realizuara në institucionet partnere në 3 vitet e fundit" Evidenca 1.18__Rregullorja e programit të studimit Skenografi-Kostumografi</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Stafi akademik i programit Bachelor në:"Skenografi-Kostumografi" mbulon ngarkesën mësimore në mënyrë të qëndrueshme, duke garantuar cilësi në procesin mësimor. Megjithatë, ngarkesa e pedagogëve me angazhim të përhershëm në disa raste është e lartë dhe mund të rishikohet për një shpërndarje më të balancuar.</i></p> <p><i>Një komponent kyç i programit është praktika profesionale, e cila zhvillohet në bashkëpunim me institucione të njohura si Teatri Kombëtar, Teatri Eksperimental, Teatri i Operës dhe Baletit, Teatri i Kukullave, si dhe media lokale. Kjo praktikë mbikëqyret nga stafi akademik me kohë të plotë dhe përfshihet në ngarkesën e tyre mësimore, duke siguruar që studentët të fitojnë aftësi të avancuara teknike dhe krijuese.</i></p>

	<i>Praktikat profesionale janë të lidhura ngushtë me kërkesat e tregut të punës dhe ofrojnë studentëve përvojë reale në ambiente profesionale, duke i ndihmuar ata të krijojnë një profil konkurrues dhe të përshtaten me standardet e industrisë artistike. Kjo lidhje e fortë me praktikën dhe tregun e punës përbën një element të rëndësishëm të programit dhe përgatit studentët për karrierë profesionale në fushën e skenografisë dhe kostumografisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë vizitës në UART u vërejt se institucioni ofron infrastrukturë të specializuar që mbështet inovacionin në mësimdhënie, me staf administrativ dhe ndihmës në shërbim të procesit mësimor. Ambientet janë të përshtatura për mësim, aktivitet artistik dhe kërkim shkencor, duke përfshirë Sallën “BlackBox” me dy ambiente (40 dhe 200 vende) të pajisura me teknologji moderne për performanca teatrore. Për evente më të mëdha, përdoren hapësira të përbashkëta si Galeria, Lektoriumi “Tonin Harapi” dhe Salla e Madhe e Koncerteve me 600 vende, e pajisur me infrastrukturë skenike dhe teknologji të avancuar për ndriçim dhe zë. Këto ambiente mbështesin në mënyrë efikase procesin mësimor dhe aktivitetet artistike të programit të “Skenografisë-Kostumografisë”. <i>Referanca:</i> RVB <i>Takimi ne Institucion</i> Evidenca 4.8 "Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të përbashkëta
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së	Gjatë vizitës, GVJ vuri re se auditorët e programit Bachelor në “Skenografi-Kostumografi” janë të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për procesin mësimor. Studentët, të cilët ishin duke punuar në ambientet e fakultetit, dhanë përshtypje pozitive për kushtet e krijuara. Për shkak të specifikave të lëndëve, departamenti bashkëpunon me

<p>informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>strukturat ndihmëse të fakultetit për të përcaktuar auditorët më të përshtatshëm.</p> <p>Mjediset dhe pajisjet mbështesin jo vetëm mësimdhënien, por edhe zhvillimin e projekteve artistike dhe kërkimore, duke ofruar kushtet e duhura për zhvillimin profesional dhe kreativ të studentëve.</p> <p>Referanca: Takimi ne Institucion Evidences 4.8 Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të përbashkëta Evidenca 4.9 Lista e pajisjeve në shërbim të S&K</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës dhe takimeve me stafin përkatës, GVJ u njoh me studiot dhe laboratorët e FAS/UART, të cilët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për realizimin e objektivave të programit Bachelor në “Skenografi-Kostumografi”. U theksua se pajisjet aktuale mbulojnë kërkesat për formimin teorik dhe praktik të studentëve, duke ofruar teknologji të specializuar sipas natyrës së programit dhe kërkesave të tregut të punës. Megjithatë, u theksua gjithashtu se, për shkak të zhvillimeve të vazhdueshme teknologjike, ekziston gjithmonë nevoja për përmirësim të mëtejshëm dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të pajisjeve në funksion të garantimit të cilësisë së mësimdhënies dhe përgatitjes profesionale të studentëve.</p> <p>Referanca: Takimi ne Institucion Evidences 4.8 Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të përbashkëta Evidencës 4.9 Lista e pajisjeve në shërbim të S&K</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Sipas RVB-së dhe gjatë takimit me stafin përkatës, u theksua se Departamenti i Skenografisë-Koreografi, përveç përdorimit të ambienteve të Bibliotekës Shkencore të UART-it të pajisura me kompjuterë dhe softuerë profesionalë, disponon edhe laboratorë të dedikuar në ambientet e tij. Këto laboratorë janë të pajisur me teknologji të informacionit që përfshijnë programe për editim audio, video, efekte speciale digjitale, 3D dhe manipulim imazhesh, të cilat përditësohen sipas nevojës. U theksua gjithashtu se, për shkak të natyrës specifike të programit, këto pajisje përdoren kryesisht për qëllime bazike</p>

	<p>ose ndihmëse, ndërkohë që mbetet e domosdoshme një mirëmbajtje dhe përmirësim i vazhdueshëm i tyre, në funksion të përputhjes me zhvillimet e tregut dhe kërkesat e programeve të specializuara.</p> <p>Referanca: Takimi ne Institucion RVB</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson se gjatë vizitës në UART, GVJ u njoh me infrastrukturën që mbështet programin Bachelor në “Skenografi-Kostumografi. Ambientet si Salla “BlackBox”, Galeria, Lektoriumi dhe Salla e Madhe e Koncerteve ofrojnë kushte të përshtatshme për zhvillim artistik dhe mësimor. Studentët ishin aktivisht të angazhuar në punë praktike dhe dhanë përshtypje pozitive.</i></p> <p><i>Auditorët dhe laboratorët janë të pajisur me mjete didaktike dhe teknologji të informacionit, ndërsa pajisjet specializohen sipas natyrës së lëndëve. U theksua nevoja për mirëmbajtje dhe përmirësim të vazhdueshëm për të përmbushur kërkesat e tregut të punës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit në institucion, ashtu siç theksohet edhe në RVB, u vu në dukje se natyra e programit Bachelor në “Skenografi - Kostumografi” kërkon një angazhim të theksuar praktik dhe krijues, i cili përbën bazën e procesit mësimor. Kjo punë praktike ndërthuret ngushtësisht me njohjen dhe përdorimin e literaturës teorike, e cila mbështetet në historikun e fushës dhe zhvillimet e saj bashkëkohore.</p> <p>Literatura bazë dhe ndihmëse për çdo lëndë është e përcaktuar në syllabus, në përputhje me rregulloren e FAS. Studentëve u mundësohet qasja në këtë literaturë përmes Bibliotekës së UART (në format fizik) dhe përmes materialeve të shtypura nga pedagogët, në rastet kur kjo parashikohet nga natyra e</p>




	<p>lëndës. Kjo qasje e kombinuar synon të mbështesë zhvillimin teorik dhe praktik të studentëve në përputhje me objektivat e programit.</p> <p>Referanca: <i>Takimi ne Institucion</i> RVB Evidenca 4.10 Lista e literatures S&K në Bibliotekën e UART Evidenca 4.11 "Linku i leksioneve të Teknikave të Produksionit skenik"</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimit, GVJ u njoh me procesin e rishikimit të vazhdueshëm të syllabuseve nga stafi akademik i Departamentit të Skenografisë dhe Kostumografisë, i cili realizohet në fillim të çdo viti akademik. U theksua se syllabuset duhet të përditësohen dhe të formatohen në përputhje me formatin zyrtar, duke reflektuar zhvillimet bashkëkohore dhe përshtatjet e nevojshme në përmbajtje, objektiva dhe literaturë.</p> <p>Gjithashtu, duke marrë parasysh historikun e konsoliduar dhe kontributin artistik të UART-it, GVJ sugjeron që stafi akademik i Departamentit të nxisë publikimin e kërkimeve të tyre shkencore e artistike, si dhe të dokumentojë dhe botojë punët e studentëve të realizuara ndër vite, të cilat përfaqësojnë një vlerë të shtuar për historikun dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit.</p> <p>Referanca: <i>Takimi ne Institucion</i> Evidencës 4.10 'Lista e literaturës S&K në Bibliotekën e UART'</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës, GVJ u njoh me proceset, hapësirat dhe fondet e ndryshme të Bibliotekës së UART-it. Biblioteka ofron ambiente moderne me pajisje kompjuterike dhe akses në burime shkencore dhe artistike, duke siguruar mundësi të barabarta për studentët e programit Bachelor në "Skenografi - Kostumografi". Gjithashtu, janë prezantuar sistemet elektronike të menaxhimit dhe katalogimit të fondeve që mbështesin kërkimin dhe përdorimin efikas të literaturës.</p> <p>Referanca: <i>Takimi ne Institucion</i> RVB</p>

	<i>Evidenca 4.12 Lista e burimeve elektronike né té cilat ka akses UART né rrugé digjitale</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në ambientet e bibliotekës GVJ konstatoi që ajo ishte e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Referanca: <i>Takimi ne Institucion</i> <i>RVB</i> Evidenca 4.13 "Lista gjithëpërfshirëse e titujve fiziké né bibliotekén e UART
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Ky kriter përmbushet nëpërmjet abonimeve që institucioni ka realizuar në bibliotekat digjitale. Të gjithë studentët dhe stafi akademik kanë akses në këto burime përmes bibliotekës online të UART. Këto platforma shërbejnë si një burim i rëndësishëm për përgatitjen e leksioneve, materialeve ndihmëse dhe për zhvillimin e aktivitetit kërkimor-shkencor. Referenca: <i>-RVB</i> <i>-Shënime nga vizita në Institucion</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=344&niveli=74
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe teknologji të tjera, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët që e frekuentojnë atë. Referenca: <i>-RVB</i> <i>-Shënime nga vizita në Institucion</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave,	Në universitetin e Arteve biblioteka qëndron e hapur prej orës 8:00 - 19:00. Gjatë takimit me studentët ata pohuan për GVJ se ishin të kënaqur me shërbimet e bibliotekës. Referenca: <i>-RVB</i> <i>-Shënime nga vizita në Institucion</i>

numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.				
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka e UART informon rregullisht njësitë bazë për mundësitë dhe fondet e disponueshme për pasurimin e literaturës. Bazuar në këto njoftime, Departamenti i Skenografisë-Koreografisë paraqet kërkesat për materialet e nevojshme për programin Bachelor në “Skenografi-Kostumografi”. Biblioteka gjithashtu raporton për fondin fizik të disponueshëm (tituj, tekste, drama, revista, buletine etj.) dhe për frekuentimin e ambienteve apo përdorimin online të burimeve.</p> <p>Referenca:</p> <p>Evidenca 4.10 Lista e literaturës S&K në Bibliotekën e UART Evidenca 4.12 Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjiitale Evidenca 4.15 Statistika të aksesit të Bibliotekës së UART</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me specifikat praktike dhe krijuese të programit, si dhe me rëndësinë e literaturës teorike, e cila është e përcaktuar në syllabus-et e përditësuara sipas formatit zyrtar dhe rregullores së FAS. U theksua nevoja për rishikim të rregullt të syllabus-eve dhe përfshirjen e zhvillimeve bashkëkohore. GVJ sugjeroi nxitjen e botimeve shkencore nga stafi dhe dokumentimin e punëve studentore të realizuara ndër vite, si vlerë për trashëgiminë artistike të UART.</i></p> <p><i>Gjithashtu, GVJ u njoh me funksionimin dhe infrastrukturën e Bibliotekës së UART, përfshirë fondet fizike dhe aksesin elektronik, që ofrojnë mbështetje të plotë për nevojat kërkimore dhe mësimore të studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve, disponon sistemin e menaxhimit në platformën "Pitagora". Nëpërmjet këtij sistemi administrohet i gjithë informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim. Çdo student ka llogarinë e tij të dedikuar në këtë sistem. Në takimin me studentët, GVJ u informua që ky sistem funksionon në mënyrë të pandërprerë dhe i plotëson të gjitha kërkesat për shërbimet që u nevoiten atyre.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Çdo vit akademik, Departamenti, në përputhje me udhëzimet dhe aktet ligjore në fuqi, përgatit dokumentacionin mbi ngarkesën mësimore dhe angazhimet e stafit akademik, përfshirë edhe veprimtari artistike apo shkencore. Këto dokumente integrohen në sistemin e brendshëm të menaxhimit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, së bashku me CV-të dhe materialet mbështetëse të stafit. <i>Gjatë takimeve të zhvilluara me zyrën e burimeve njerëzore, GVJ vërejti se disa nga dosjet e stafit PAK paraqisnin mungesa në dokumentacionin përkatës.</i></p> <p>Informacioni për stafin dhe studentët ofrohet përmes sistemit PITAGORA, i cili mundëson akses në njoftime mbi provimet, notat, vërtetime dhe rezultate në kohë reale. Për më tepër, informacioni publikohet edhe në faqen zyrtare të universitetit.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit "Pitagora" është i instaluar në platformën "Microsoft Office 365" dhe arrihet nëpërmjet adresës së dedikuar për çdo individ. Ai përmban module insertimi, leximi dhe editimi, të cilat mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Sistemi mundëson shkëmbim e materialeve didaktike, komunikim, realizimin e konsultimeve audio-vizuale online, përdorim të paketës office, akses në email-in universitar, etj.</p>

	<p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidenca 4.19 Manuali Pitagora</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit “Pitagora” garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Informacionet jepen nëpërmjet domenit https://uart.pitagora.rash.al/login, i cili i afishon ato në rubrika të posaçme.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://uart.pitagora.rash.al/login</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Universiteti i Arteve ka domenin e tij në internet, platforma google, i cili arrihet në adresën http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=121&niveli=19. Në këtë adresë gjenden të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në rang institucioni, njësisht kryesore, njësisht përgjegjëse, programesh studimi, partnerët strategjikë etj. GVJ e vizitoi këtë faqe dhe konstaton plotësimin e kriterit.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -https://uart.pitagora.rash.al/login -http://uart.edu.al/index.php</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti i Arteve disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit institucional Pitagora dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ edhe për programin e studimit BSC “Skenografi-Koreografi”.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të

studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik hartohet buxheti vjetor i programit bazuar në objektivat dhe programin mësimor të programit të studimit.</p> <p>Buxheti merr parasysh kërkesën dhe nevojën për burime njerëzore akademike dhe administrative në shërbim të programit, burime infrastrukturore, logjistike dhe didaktike si dhe investime afatgjata ku përfshihen pajisje për klasat, laboratore dhe investime të tjera. Buxheti gjithashtu parashikon burimet e financimit të kostove të përmendura mësipër. GVJ rekomandon fuqizimin e burimeve të tjera financiare me qëllim që të rritet siguria në jetëgjatësinë e programit.</p> <p>Referenca: -RVB Evidenca 4.24 "Paraqitja e buxhetit nga administratori i FAS Evidenca 4.25; 4.26; 4.27</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Shpenzimet për burimet njerëzore, akademike dhe administrative që i shërbejnë programit vijnë me kërkesë të paraqitur nga Njësia Bazë, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Skenografi-Kostumografi"</p> <p>Për këtë program, Njësia Bazë mbulon financiarisht stafin akademik me kohë të plotë; ndërkaq stafi me kohë të pjesshme gjenerohet nga vetë të ardhurat e institucionit. Gjithashtu përgjatë vizitës në lidhje me mbështetjen për buxhet për shpenzimet lidhur me mjediset apo teknologjite e reja, merren në konsideratë.</p> <p>Për të siguruar një mbarëvajtje të programit të studimit gjithmonë në lidhje me financimin për stafin; përmisimin dhe kualitetin e mësimdhënies; mjediset; mjetet; sygjerohet të zhvillohen shkëmbime stafi me profile studimi të së njëjtës trajtë studimi; apo pjesëmarrje në projekte të cilat do të mundësonin një vazhdimësi të sigurt për programin në koherencë me zhvillimet më të fundit në fushën e kostumografise dhe skenografise.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni</p>	<p>UART nuk i është nënshtuar ndonjë auditimi financiar.</p>

<p>kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Drejtoria e financave dhe bordi i administrimit janë njësitë të cilat miratojnë dhe shpërndajnë grantet në UA.</p> <p>Për të diversifikuar burimet e të ardhurave, sygjerohet më tej të ardhurat dytësore në mënyrë që të ulët risku i “goditjeve” nga rëniet e përkohshme të numrit të studentëve, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në projektet e financuara nga donatorë si EU, IIK, SIDA etj.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidencës 4.33 "Dokumente nga drejtoria ekonomike mbi raportimin e realizimit të buxhetit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Deri më tani, institucioni nuk ka pasur nevojë të ndërhyjë për përmirësimin e gjendjes financiare. Megjithatë, në funksion të përmbushjes së misionit për të ofruar një mësimdhënie cilësore dhe të pajisur me kushte bashkëkohore teknologjike, Departamenti i S&K/FAS ka aplikuar me projekte që synojnë sigurimin e burimeve shtesë financiare.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në vlerësimin e përgjithshëm të përmbushjes së kërkesave të këtij standardi, GVJ konstatoi se Universiteti i Arteve, në lidhje me hartimin e raportit financiar për kostot e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, dhe planin për mbështetje financiare, ka një strukturë financimi të diversifikuar. Burimet e financimit për Njësinë Bazë përfshijnë grante nga buxheti i shtetit, të ardhura të krijuara nga institucionet dhe burime të tjera me destinacion të caktuar. Për programin e studimit dhe njësinë përkatëse, projekt-buxheti afatmesëm dhe ai vjetor hartohen nga administratori i Universitetit të Arteve, nëpërmjet drejtorisë ekonomike.</i></p>




	<i>Planifikimi financiar fillon çdo vit kalendarik, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe udhëzimet përkatëse të lidhura me të. GVJ sugjeron që të bëhet një diversifikim më i madh i burimeve financiare, me qëllim që të ardhurat nga tarifat e studentëve të mbeten të përballueshme për ta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Në Universitetin e Arteve, përfshirë Fakultetin e Artit Skenik, formimi i studentëve nga pranimi deri në përfundim të studimeve mbështetet në Rregulloren e programit të studimit. Rregullorja për programin Bsc. në "Skenografi -Kostumografi" është hartuar bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, aktet nënligjore dhe VKM Nr. 145, datë 13.03.2021, si dhe në Rregulloren e Departamentit të Interpretimit. Ajo miratohet në Dekanat dhe Senat, duke respektuar natyrën specifike të programit.</p> <p>Për pranimin në këtë program, studentët i nënshtrohen konkurseve të organizuara çdo vit, sipas një rregulloreje të veçantë që miratohet nga Senati dhe publikohet në faqen zyrtare të universitetit. Në takimin me studentët GVJ u informua se ata i njihnin këto procedura dhe konfirmonin që zbatimi i tyre ishte në dobi të gjithë aktivitetit të tyre në institucion.</p> <p>Referenca</p> <p>Evidenca 1.4: VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 – "Për dhënien e statusit të veçantë UART"</p> <p>Evidenca 1.5: Statuti i UART</p> <p>Evidenca 5.1: Rregullorja e Universitetit të Arteve</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Evidenca 1.15: Rregullorja e Ciklit të I-rë të Studimeve (Bachelor)</p> <p>Evidenca 1.17: Rregullorja e Departamentit të Skenografisë dhe Kostumografisë</p> <p>Evidenca 1.18: Rregullorja e Programit të Studimit Skenografi dhe Kostumografi</p> <p>Evidenca 4.16: Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Jo vetëm në dokumentacionin e konsultuar por edhe në takimet në insitucion, kryesisht gjatë takimit me studentët, GVJ konstaton që politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Bsc “Skenografi-Kostumografi”. Si të drejtat ashtu edhe detyrimet ishin të njohura nga studentët edhe nëpërmjet dokumentacionit të publikuar nga institucioni, edhe nga veprimtaria konkrete që zhvillohej gjatë kohës së studimeve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të konsulencës nga zyrat përkatëse.</p> <p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion GVJ u informua që Universiteti i Arteve bazuar në kërkesat e MAS, rregulloren didaktike, rregulloren e programit Bsc “Skenografi-Kostumografi”, me propozim të departamentit, miratim të fakultetit dhe vendim të Senatit Akademik, përcakton kriteret e pranimit dhe kuotat e pranimit për kandidatët që duan të studiojnë në PS. Si dhe kriteret për konkursin përkatës për këtë program studimi. Gjithashtu gjatë takimit GVJ evidentoi faktin se tashmë është bërë traditë dhe aspekti i integritetit të OPEN Day për UART, si dhe pjesëmarrje në panairët e karrierës nëpërmjet njësive përkatëse. Në takimin me studentët, GVJ konstaton që ata janë njohur me kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe në plotësim të tyre.</p> <p>Referenca:</p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>Evidenca 5.1: Rregullorja e Universitetit të Arteve</p> <p>Evidenca 1.15: Rregullorja e Ciklit të I-rë të Studimeve (Bachelor)</p> <p>Evidenca 1.17: Rregullorja e Departamentit të Skenografisë dhe Kostumografisë</p> <p>Evidenca 1.18: Rregullorja e Programit të Studimit Skenografi dhe Kostumografi</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Gjatë takimeve në Fakultetin e Artit Skenik (FAS), u konstatua se kandidatët për programet e ciklit të parë i nënshtrohen konkurseve të pranimit, të organizuara sipas rregullores dhe kritereve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve (UART). Departamenti i Skenografisë-Koreografisë përcakton kuotat, tarifat, kriteret dhe rregulloret e pranimit në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Propozimet e departamentit shqyrtohen nga Dekani i FAS dhe miratohen nga Senati Akademik.</p> <p>Konkursi zhvillohet çdo vit akademik dhe përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hartimin e një skice skenografike dhe kostumografike mbi temë të caktuar; • Bashkëbisedim mbi formimin kulturor në fushën e artit skenik dhe artet e tjera; • Punim në telajo të një modeli nga natyra në ateliein e departamentit. <p>Studentët mund të pranohen nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci, Medvegja dhe vende të tjera, me certifikim të gjuhës shqipe.</p> <p>Kuotat, kriteret dhe tarifat bëhen publike në faqen zyrtare të fakultetit dhe në ambientet e njoftimeve. Dekanati ngrit grup pune për organizimin dhe funksionimin e procesit, sipas Urdhrit të Rektorit për masat në konkurse.</p> <p>Të gjitha këto procedura respektojnë rregulloret dhe udhëzimet ligjore në fuqi për ciklin e parë të studimeve në UART.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidenca 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Skenografi - Kostumografi Evidenca 5.2 FAS Kriteret dhe Rregulloret e konkurseve Bachelor 2021-2022</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit,</p>	<p>Konkursi zhvillohet në tre ditë dhe synon të vlerësojë aftësitë teknike, krijuese dhe konceptuale të kandidatëve: Kandidatët realizojnë punime mbi një temë të caktuar, ku vlerësohen për kreativitetin, teknikën dhe përshtatjen me temën, i cili vlerësohet për origjinalitet, përpunim teknik dhe vëmendje ndaj</p>




<p>njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>detajeve. Dhe ditën e fundit zhvillohet takimi me stafin ku prezantohet portofolio personale. Vlerësohen diapazoni i aftësive, përputhshmëria me programin dhe organizimi i materialeve. Kriteret e pranimit dhe udhëzimet e plota publikohen në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe mund të merren edhe pranë Sekretarisë Mësimore. Kriteret për pranimin e studentëve në konkurs janë të publikuara në ëbsite-in zyrtar të programit dhe mund të merren nga sekretaria mësimore e universitetit. Ky informacion përfshin detaje mbi dokumentet që kërkohen, afatet, dhe kriteret e përzgjedhjes.</p> <p>Vizita në isntitucion</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimeve, GVJ u informua se kuotat e pranimit, kriteret dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve, së bashku me përqindjen e pikëzimit të konkurseve, pasi miratohen nga Senati Akademik i UART, bëhen publike në faqen e internetit të fakultetit dhe në ambientet e përcaktuara pranë FAS. Për të mbështetur informimin e publikut dhe kandidatëve të mundshëm, institucioni organizon para fillimit të çdo viti akademik takime të hapura të stafit akademik me kandidatët e interesuar për të ndjekur programet bachelor, ku shpjegohen kriteret, procedurat, tarifat dhe mundësitë e regjistrimit, si dhe mundësitë e mobilitetit. Në zbatim të Urdhrit të Rektorit për masat e konkurseve të pranimit, Dekani i FAS ngrit një grup pune me detyra dhe afate të përcaktuara, duke siguruar organizimin dhe funksionimin e stafit administrativ dhe akademik. Ky urdhër publikohet në rubrikën e njoftimeve në ambientet e FAS dhe në të gjitha faqet elektronike</p> <p>Referencë:</p> <p>Evidencës 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-rë" Evidencës 5.2 "FAS Kriteret dhe Rregulloret e konkurseve Bachelor 2022-2023"</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e</p>	<p>Gjatë takimit të zhvilluar me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), Universiteti i Arteve informoi se, si institucioni i vetëm publik që ofron arsim të lartë në fushën e arteve, në përputhje me parimin e barazisë, nuk kishte përcaktuar kriteret specifike</p>

<p>kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>për përzgjedhjen e kandidatëve nga grupet minoritare, shtresat e marginalizuara apo me aftësi të kufizuara. Në vend të kësaj, ishin përcaktuar kuota të dedikuara pranimit për këto kategori, me qëllim garantimin e aksesit të barabartë në programet e studimit.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Gjatë vizitës dhe sipas RVB, u konstatua se Universiteti i Arteve respekton parimin e meritës dhe barazisë, pa vendosur kriteret të veçanta për kandidatët e huaj. Ata mund të konkurrojnë nëse kanë diplomë të njësuar sipas ligjit. Studimet mund të ndiqen edhe nga shtetas të huaj sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, me kusht që të zotërojnë gjuhën shqipe, e vërtetuar përmes certifikatave përkatëse.</p> <p>Referencë Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-rë"</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Universiteti i Arteve ofron bursa për studentët që përfshijnë kategoritë e mëposhtme: Bursa për studentët në nevojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentë nga familje që marrin ndihmë ekonomike; • Bashkëshortë me fëmijë që janë të dy studentë në universitete publike; • Studentë me aftësi të kufizuara; • Studentë që kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara; • Studentë që kanë një prind pensionist dhe prindin tjetër të ndjerë; • Studentë që kanë të dy prindërit pensionistë; • Studentët, të tretët ose më lart, nga familje me tre ose më shumë fëmijë, ku dy të parët janë studentë në universitete publike; • Studentët që kanë statusin e jetimit deri në moshën 25 vjeç; • Studentë që kanë humbur përgjegjësinë prindërore përmes vendimit të gjykatës deri në moshën 25 vjeç; • Studentë të identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore deri në moshën 25 vjeç; • Studentë që janë fëmijë të forcave të rendit të rënë në detyrë;

	<ul style="list-style-type: none"> • Studentë romë dhe egjiptianë; • Fëmijët e ish të dënuarve politikë; • Studentë me një prind me aftësi të kufizuar që përfitojnë pagesën për aftësi të kufizuar. <p>Bursa sipas meritave:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentë të vitit të parë me mesatare mbi 9; • Studentë të vitit të dytë ose të tretë me mesatare mbi 9. <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidenca 5.11 "VKM nr. 780, datë 26/12/2018 – Kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit" Evidenca 2.4 "VKM nr. 251, datë 27/03/2020 – Për përjashtimin nga pagesa të studentëve Romë/Ballkano–Egjiptianë" Evidenca 5.12 "VBA nr. 4, datë 16/02/2023 – Reduktimi i tarifave të shkollimit"</p>								
Konkluzione	<i>Në përfundim të shqyrtimit të përmbushjes së këtij standardi, GVJ vlerëson se Universiteti i Arteve zbaton politika dhe procedura të qarta institucionale për pranimin, përzgjedhjen, përparimin, transferimin, njohjen dhe vlerësimin e njohurive të studentëve, si dhe për diplomimin e tyre. Këto procedura janë të standardizuara dhe sigurojnë funksionimin e qëndrueshëm të programit të studimit Bachelor në Skenografi-Kostumografi.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje	<p>Rregulloret e përgjithshme dhe rregullorja e programit të studimit përshkruajnë me imtësi modalitetet e përparimit akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e UART; - Rregullorja e ciklit të parë të programeve Bachelor; - Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore; - Rregullorja e Departamentit të Skenografi – Kostumografi; - Rregullorja e programit të studimit. <p>Gjithashtu, në kontakt të vazhdueshëm me studentët është edhe personeli i departamentit dhe i programit të studimit, që informon studentët dhe trajton</p>

<p>me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>çështje specifike gjatë procesit mësimor. Studentët informohen për përparimin e tyre dhe kriteret dhe procedurat e vlerësimit përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacionit të dhënë në klasë nga stafi pedagogjik; • Informacionit të ofruar përmes sekretarisë mësimore; • Informacioni i marrë në ëeb dhe përmes sistemit PITAGORA; • Informacionit të dhënë në Departamentin e SK; <p>Gjatë takimit me studentët, GVJ vërejtë se studentët ishin të informuar mirë.</p> <p>Evidenca 1.16 "Rregullorja e Njesisë Kryesore FAS" Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit Skenografi dhe Kostumografi"</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në UART pranohen transferime të studentëve nga universitete dhe shkolla të tjera arti, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, dhe lejohet largimi i studentëve për në institucione të tjera të arsimit të lartë, sipas procedurave të parashikuara. Për të transferuar studimet në UART, studenti duhet të ketë marrë të paktën 48 kredite në programin përkatës. Fakulteti mund të njohë kreditet e fituara nëse ato përputhen me kriteret e ekuivalentimit të lëndëve. Komisioni i njohjes dhe ekuivalentimit, i ngritur nga Dekani, shqyrton dhe vendos për njohjen e krediteve dhe lëndëve, duke marrë parasysh përputhshmërinë e programeve dhe krediteve. Në rast të njohjes së pjesshme, studentit mund t'i caktohet shlyerja e pjesës së mbetur të programit, me mundësi për të realizuar provime ose detyra të tjera të përcaktuara nga komisioni. Në dokumentacionin bazë të institucionit jepen informacionet që lidhen me kriteret dhe procedurat e njohjes të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Këto informacione merren edhe tek zyrat përkatëse të institucionit si Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës.</p> <p>Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Skenografi dhe Kostumografi"</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i S&K, përmes Sekretarisë Mësimore të FAS, informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit. Pedagogët në çdo lëndë prezantojnë komponentët e vlerësimit dhe peshën përkatëse. Në FAS, mësimdhënia zhvillohet individualisht për lëndët speciale dhe në grupe për lëndët artistike e bazë. Informimi i studentëve mbi programin mësimor, provimet dhe detyrimet kryhet nga vetë pedagogët.</p> <p>Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Skenografi dhe Kostumografi"</p>
<p>Kriteri 4.</p>	<p>Institucioni informon rregullisht studentët për kriteret dhe procedurat e</p>

<p>Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>diplomimit. Departamenti, përmes stafit akademik, u ofron udhëzime të detajuara mbi përgatitjen e diplomës, përzgjedhjen e temave, rregulloren përkatëse, si dhe mbi çështjet e plagjiaturës, pronësisë intelektuale dhe mënyrat e referimit. Para dorëzimit, studentët plotësojnë vetëdeklarimin për mungesë plagjiature.</p> <p>Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Skenografi dhe Kostumografi"</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Në universitetin e Arteve ky kriter plotësohet duke organizuar për studentët ditët e hapura të dedikuara për çdo program studimi në mënyrë që studentët të njihen më nga afër me infrastrukturën e universitetit, ambientet laboratorike, ateliet, e sallat, kurrikulën e programit, akreditimin institucional etj. Po ashtu studentët pajisen me guidën e studentit si dhe u rekomandohen rubrikat përkatëse të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Universiteti i Arteve merr pjesë edhe në panaiet informuese të organizuara në qytetet e ndryshme të vendit, ku përveç përfaqësuesve të zyrës së pranimeve është i pranishëm edhe një përfaqësues i personelit akademik, për të informuar mbi ofertat mësimore të universitetit.</p> <p>Evidenca 5.13 "Open Day UART Dhjetor 2024" https://www.instagram.com/p/DDMpQZSIoM/?igsh=N31ndmEyamlxdDhY https://www.facebook.com/share/p/168w2HXQvh/?mibextid=wwX1fr http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=1316</p>
<p>Konkluzio</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ</i></p>

ne	vlerëson që Universiteti i Arteve vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bsc në "Skenografi-Kostumografi", informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>GVJ u informua se studentët njoftohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit përmes takimeve informuese në shkollë të mesme me profil artistik dhe në ambientet e Fakultetit të Artit Skenik gjatë periudhës së regjistrimit dhe fillimit të vitit akademik. Gjithashtu, pedagogët dhe koordinatorët ofrojnë orientime gjatë studimeve për organizimin e programit. Institucioni ofron materiale promovuese dhe informuese si fletëpalosje, postera dhe video, ndërsa informacioni i plotë dhe i detajuar është i aksesueshëm në faqen zyrtare të universitetit, ku gjenden edhe planet mësimore.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Faqia Web e Programit të Studimit Bachelor në Skenografi dhe Kostumografi</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Studentët njihen me planin mësimor të profilit të tyre, syllabuset e çdo lënde, veprimtaritë përkatëse mësimore (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, detyra) dhe procedurat e vlersimit të njohurive. Këto informacione u transmetohen atyre në mënyrë të vazhdueshme qysh me fillimin e programit të studimeve e deri në diplomim. Sipas profilit të tyre, studentët udhëzohen ti gjejnë këto informacione edhe në faqen zyrtare të institucionit. Gjatë takimit me studentët GVJ konstaton që ata i zotërojnë të gjitha informacionet e kërkuara.</p> <p>Referenca: -RVB</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>-Shënime nga vizita në Institucion Plani mësimor i programit të studimit Syllabuset e lëndëve</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Programi Bsc në "Skenografi-Kostumografi" është një profil i cili ka nisur që me fillimet e vetë universitetit dhe në Fakultetin e Artit Skenik, që synon përgatitjen e muzikantëve të kualifikuar në muzikën moderne, duke plotësuar një boshllëk në tregun e punës. Studentët informohen për mundësitë e punësimit në institucione kulturore publike dhe private, media, orkestra, shkolla artistike e jo-artistike, si dhe në produksione muzikore kombëtare e ndërkombëtare. GJV konstatoi, në varësi edhe të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe takimeve të zhvilluara, që ky program është i orientuar drejt tregut të punës dhe u ofron studentëve perspektiva të qarta punësimi, sepse është një fushë studimi shumë specifike. Informacioni për programin është i aksesueshëm edhe në faqet zyrtare të UART dhe në sekretariatë mësimore.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidenca 1.21 "Marrëveshjet me partnerët UART"</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Të gjithë studentët e PS e Bsc "SK" kanë akses në sistemin interaktiv të universitetit "Pitagora", ku gjejnë të gjitha informacionet për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor si dhe logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Po ashtu, në dispozicion të tyre janë edhe zyrat përkatëse në institucion të cilat i ofrojnë këto shërbime sa herë u kërkohen nga të interesuarit.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në</p>	<p>Plani mësimor, lëndët, kreditet dhe syllabus-et janë të aksesueshme në sistemin PITAGORA dhe faqen zyrtare të UART, duke i ndihmuar studentët të organizojnë angazhimet akademike.</p> <p>Faqja zyrtare e Universitetit të Arteve: Sistemi PITAGORA – https://uart.pitagora.rash.al/login</p>

distancë.				
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti i Arteve vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bsc "Skenografi-Kostumografi" informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4							
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në universitet se sekretaria mësimore mbledh dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me studentët dhe performancën e tyre. Ky program nuk ka ende të diplomuar.						
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Gjatë vizitës në UART, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve.</p> <p>Në tri vite akademike numri i studentëve të regjistruar për programin e studimit: Bachelor në: "Skenografi-Kostumografi", është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="593 1554 1394 1639"> <tr> <td>2022-2023</td> <td>2023-2024</td> <td>2024-2025</td> </tr> <tr> <td>10 studentë</td> <td>8 studentë</td> <td>7 studentë</td> </tr> </table> <p>Në këtë program nuk rezultojnë transferime apo dhe largime, referuar tabelës (Tabela 21) në RVB.</p> <p>Këto të dhëna i referohen shtojcave të RVB si dhe ruhen në sekretarinë mësimore sipas formateve standarde të MAS dhe QSHA.</p>	2022-2023	2023-2024	2024-2025	10 studentë	8 studentë	7 studentë
2022-2023	2023-2024	2024-2025					
10 studentë	8 studentë	7 studentë					

Evidenca Tabela 21.	
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore ruan të dhënat për të gjithë studentët. Kjo përfshin statusin, notat, frekuentimin, dhe informacionet e tjera të rëndësishme për avancimin e studentit. Pjesa e këtyre të dhënave është e dukshme për studentët përmes sistemit PITAGORA, të mundësuar nga RASH, ndërsa të tjera janë të aksesueshme nga stafi i specializuar që mund të krijojë statistika ose analiza të të dhënave.</p> <p>GVJ konstatoi gjatë vizitës se sekretaria mësimore gjithashtu ruan të dhënat zyrtare në letër, sipas formateve standarde të kërkuara. Përveç përfaqësimit në organet vendimmarrëse, studentët kontribuojnë në vlerësimin e procesit akademik përmes sondazheve të Sektorit Mësimor, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e programeve dhe mësimdhënies.</p> <p>Evidencë Nv. 3.13 Faqja e web-it të UART, sistemi PITAGOIU. https://uart.pitagora.rash.al/login</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës, GVJ u njoh me mënyrën e funksionimit të Sektorit Mësimor, i cili, sipas rregullores së miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve, është përgjegjës për kryerjen e kontroleve periodike në të gjitha njësitë përgjegjëse, përfshirë sekretaritë mësimore dhe sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit.</p> <p>Ky sektor monitoron dhe dokumenton rregullisht saktësinë e të dhënave që lidhen me studentët dhe veprimtarinë e tyre akademike. Gjatë takimeve, u evidentua se Sektori Mësimor kryen kontrole mbi regjistrat e notave dhe verifikon përputhshmërinë e tyre me regjistrimet e bëra nga stafi i sekretarive mësimore, duke garantuar integritetin dhe besueshmërinë e të dhënave akademike në institucion.</p> <p>Evidencë 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre</p>	<p>Gjatë vizitës, GVJ u njoh me veprimtarinë e Sektorit Mësimor, i cili, sipas rregullores së miratuar nga Senati Akademik, kryen kontrole periodike në njësitë përgjegjëse dhe sekretaritë mësimore për të verifikuar saktësinë e të dhënave akademike të studentëve. Ky sektor siguron përputhshmërinë e regjistrimeve me dokumentacionin përkatës, duke garantuar integritetin e procesit mësimor.</p> <p>Referenca: -RVB</p>

traguesve.	-Shënime nga vizita në Institucion Evidencë 1.25 "Raportet e vlerësimit të performancës vjetore			
Konkluzione	<i>GVJ vizitoi sekretarinë mësimore dhe shqyrtoi me hollësi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga universiteti. Bazuar në sa më sipër konstatojmë se të dhënat ruhen si në formë të printuar ashtu edhe në formë digjitale. Të dhënat janë të detajuara dhe lehtësisht të aksesueshme. Universiteti prodhon raporte dhe analiza periodike bazuar në të dhënat e ruajtura.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>GVJ u njoh me pjesëmarrjen aktive të studentëve në jetën institucionale të Universitetit të Arteve. Studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, komisionet për Sigurimin e Cilësisë dhe Marrëdhëniet me Studentët, si dhe në Këshillin Studentor. Përmes këtyre strukturave, ata kanë mundësi të japin mendime dhe propozime për çështje që lidhen me jetën akademike dhe institucionale. Universiteti mbështet Këshillin Studentor dhe nxit përfshirjen e studentëve në veprimtari artistike, duke i angazhuar ata si bashkëpunëtorë të barabartë në projekte me pedagogët.</p> <p>Për programin e studimit në “Skenografi-Kostumografi”, GVJ u njoh me përfshirjen aktive të studentëve në proceset akademike, artistike dhe institucionale, si dhe me rolin e tyre në zhvillimin e projekteve krijuese në bashkëpunim me stafin pedagogjik.</p> <p>Evidenca 1.1 "Ligji i Arsimit të Lartë nr. 80/2015 – Kreu III" Evidenca 1.5 "Statuti i UART – Kreu III" Evidenca 1.16 "Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS"</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga takimi me studentët rezultojnë se ata janë të vetëdijshëm për përfaqësimin e tyre dhe e gjejnë deri diku efikase mënyrën si adresohen problemet dhe mendimet e tyre.</p> <p>Duhet theksuar se, duke qenë një universitet i vogël, është e lehtë që secili të dëgjohet. Universiteti rezultojnë të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Departamenti Skenografise-Koreografisë është në komunikim të vazhdueshëm me studentët përmes aktiviteteve mësimore. Sektori mësimor gjithashtu realizon sondazhe mbi programin e studimit me studentët dhe personelin akademik.</p> <p>Duhet theksuar se, duke qenë një universitet i vogël, është e lehtë që secili të dëgjohet. Universiteti rezultojnë të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas.</p> <p><i>Evidenca 5.16 "Sondazhet e kryera nga Sektori Mësimor"</i> <i>Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS nga Sektori Mësimor"</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Referuar rregullores së programit të studimit, Neni 19, përcaktohen mënyrat e vlerësimit të studentit dhe mundësitë e ankimimit.</p> <p>Komunikimi i rezultateve bëhet në një seancë të posaçme ku studenti ka mundësi të njihet me vlerësimin dhe të shprehë mendimin e tij. Brenda 24 orëve nga marrja e rezultatit, studenti ka mundësi të ankohet për rezultatin. Në këto raste, Dekani verifikon rastin dhe jep edhe vlerësimin përfundimtar. Gjatë vizitës së GVJ, nuk u identifikua asnjë rast konkret ankimimi.</p> <p>Evidenca 1.16 "Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS" Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-ré të studimit"</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar mirë dhe të angazhuar në nivele të ndryshme si një pjesë e rëndësishme e universitetit dhe e programit specifik. Studentët janë të përfaqësuar drejtpërdrejt por edhe indirekt përmes kontaktit të vazhdueshëm me personelin akademik. Universiteti rezultojnë të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, për</i></p>

	<i>shkak të shkallës së vogël, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>GVJ, përgjatë takimeve dhe në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, konstatoi se Universiteti i Arteve ka ngritur struktura funksionale për informimin dhe mbështetjen e studentëve, si Sekretaria Mësimore dhe Sektori Mësimor. Këto njësi ndjekin dhe dokumentojnë ecurinë akademike të studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve, duke ofruar asistencë për çështje akademike e administrative. Informimi realizohet në mënyrë të rregullt përmes faqes zyrtare të institucionit, postës elektronike, njoftimeve në stenda dhe kontakteve të drejtpërdrejta me pedagogët.</p> <p>Evidenca 4.16 "Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAS" Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART" Evidenca 5.17 "Rregullorja e Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët"</p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me strukturën e universitetit dhe rezultojnë të jenë të informuar mirë dhe të kënaqur me nivelin e komunikimit dhe ndihmës. Ata marrin informacionin kryesor përmes internetit (web dhe social media) dhe sistemit PITAGORA, i cili u mundëson atyre të aksesojnë të dhëna dhe informacionet e rëndësishme për avancimin e tyre individual në program. Nga ana tjetër, Sekretaria Mësimore, Sektori Mësimor dhe Departamenti duket se janë efikasë dhe të dobishëm në procesin e informimit dhe këshillimit.</p> <p>Evidences 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART" Evidencë Nr. 5.12 – Sistemi PITAGORA i UART: https://uart.pitagora.rash.al/login</p>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin	Sektori Mësimor, ku përfshihen struktura e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, është




<p>e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>përgjegjës për informimin dhe asistencën e studentëve për aktivitetet e përditshme brenda universitetit. Në rregulloren e tij thuhet: Zyra mësimore, informimit të studentëve, karrierës dhe alumni. zbaton detyrat si më poshtë: Mban marrëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejton procesin e këshillimit të studentëve, mban komunikim me tregun e punës, si dhe ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve në fushën e arit dhe të kulturës. Përditëson bazën e të dhënave të institucioneve me të cilat UART ka marrëveshje bashkëpunimi, të cilat kanë në funksion Karrierën dhe punësimin e ardhshëm të të studentëve të UART. Në rastin e programit të studimit, një pjesë e studentëve fillojnë të lidhen me tregun e punës para diplomimit. Tregu i punës është ende i etur për profesionistë të rinj, kështu që në këtë rast, puna e zyrës së karrierës është disi më e lehtë.</p> <p>Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART" Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit"</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Gjatë takimeve, GVJ u vu në dijeni se Universiteti i Arteve ka krijuar një strukturë të dedikuar për Këshillimin e Karrierës dhe Alumni-n, e cila mban lidhje të ngushta dhe të vazhdueshme me ish-studentët. Kjo strukturë duhet të zhvillojë një bazë të dhënash tashmë për të parë punësimin e studentëve në tregun e punës.</p> <p>Evidences 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART Të dhëna mbi alumni (tabela 23).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se Universiteti i Arteve ofron një ambient edukativ të strukturuar dhe funksional për studentët, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme përmes Sektorit Mësimor dhe Sekretarisë Mësimore, në bashkëpunim me departamentet përkatëse. Këto struktura ofrojnë mbështetje të plotë për çështje akademike dhe administrative, duke siguruar një ndërveprim të vazhdueshëm dhe efikas me studentët. Takimet me studentët tregojnë se ata komunikojnë lehtësisht dhe zgjidhin çdo problem që lidhet me studimet e tyre, duke kontribuar në një proces edukativ pa pengesa. Kjo mbështetje është një element kyç për suksesin dhe cilësinë e programit të studimeve. Sygjerohet që struktura e këshillimit të karrierës</i></p>

	<i>dhe alumnit të ketë të dhëna mbi punësimin e studentëve në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Përgjatë takimit në UART, GVJ u njoh jo vetëm me procesin e punës, por edhe me vizionin e përgjithshëm për programet që ofron institucioni. Universiteti i Arteve zbaton një qasje unike dhe bashkëkohore në programin BSC në “Skenografi-Kostumografi” duke e përshtatur me kërkesat e fushës dhe nevojat e studentëve. Programi ndërthur metoda tradicionale dhe moderne të mësimdhënies, duke nxitur krijimtarinë, individualitetin dhe formimin artistik të studentëve.</p> <p>Kurrikula është e integruar dhe mbulon si aspektet historike ashtu edhe ato bashkëkohore të skenografisë dhe kostumografisë, duke u ofruar studentëve përgatitje të plotë teorike dhe praktike për tregun profesional. Programi synon zhvillimin e aftësive për krijimin e veprave novatore në artin skenik.</p> <p><i>Referanca</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>Shënime gjatë vizitës</i></p> <p><i>Evidences 2.1 - Plani Mesimor i Programit BSC Skenografi dhe Kostumografi</i></p> <p><i>Evidencës 2.2 - Syllabuset e Programit BSC Skenografi dhe Kostumografi</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ u informua në lidhje me mekanizmat e përdorur për monitorimin dhe vlerësimin periodik të ecurisë së programeve të studimit dhe aftësive mësimdhënëse, përmes sondazheve dhe pyetësorëve të zhvilluara me studentët dhe pedagogët nga Sektori Mësimor dhe departamentet përkatëse. Gjatë takimeve, u theksua rëndësia e mbështetjes për kualifikimin e personelit akademik dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërmjet departamenteve. Për më tepër, GVJ u njoh me analizat vjetore të punës, që përfshijnë rekomandime për përmirësimin e proceseve mësimore dhe aftësive mësimdhënëse.</p> <p>Referanca</p> <p>RVB Shënime gjatë vizitës Foto apo postera eventesh Evidence 3.7 – Rezultatet e pyetësorit për studentët Evidence 6.1 – Pyetësori për stafin akademik Evidence 1.25 – VSA Nr. 2, datë 10.01.2025 – Raporti Vjetor 2023–2024</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në Universitetin e Arteve, studentët janë në qendër të procesit mësimor dhe përfshihen në çdo fazë të zhvillimit të programeve – nga prezantimi i lëndëve te mënyra e vlerësimit dhe paraqitjet përfundimtare. Procesi mësimor mbështetet në komunikim të vazhdueshëm mes studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Studentët japin vlerësim periodik për proceset akademike përmes sondazhit të studentëve, nga i cili hartohet një raport përmbledhës që adreson gjetjet përkatëse. Sipas Rregullores së programit të studimit, ata kanë të drejtën të ankimojnë për vlerësimet e tyre.</p> <p>Megjithatë, GVJ gjatë takimeve nuk konstatoi raste konkrete ankimimesh. Përmasat e vogla të programit krijojnë një marrëdhënie të afërt dhe komunikim të drejtpërdrejtë mes studentëve dhe stafit, gjë që ndihmon në zgjidhjen e çështjeve pa nevojën për mekanizma formalë ankimimi.</p> <p>Referanca</p> <p>RVB Shënime gjatë vizitës Evidence 1.15 – VSA Nr. 16, datë 07/10/2021 – Rregullorja Mësimore e Ciklit të I të Studimeve Bachelor, Neni 20, pika 1</p>

	<p><i>Evidence 1.5 – VSA Nr. 15, datë 30/08/2021 – Statuti i UART, Neni 123, pika 2</i></p> <p><i>Evidence 6.2 – VSA Nr. 26, datë 24/05/2023 – Rregullore për zgjedhjet e Këshillit Studentor, Neni 21</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se monitorimi i cilësisë në Universitetin e Arteve realizohet përmes pyetësorëve të studentëve, ndërsa rezultatet e mbledhura publikohen dhe shpërndahen në disa forma. Ato prezantohen në takime informuese me studentë, staf akademik dhe administrativ, ku diskutohen gjetjet dhe propozohen përmirësime të mundshme. Departamenti kryen analiza vjetore mbi rezultatet e monitorimit, duke identifikuar pikat e forta dhe dobësitë, që ndihmojnë në hartimin e strategjive për zhvillim dhe përmirësim. Rezultatet e vlerësimit apo raportet analitike përkatëse nuk rezultojnë të aksesueshme dhe publike. Rekomandohet bërja publike e rezultateve duke shfaqur analiza të përgjithshme e duke shmangur informacione apo të dhëna që lidhen me individë.</p> <p>Referanca</p> <p>RVB</p> <p>Shënime gjatë vizitës</p> <p>Evidenca 6.3: Foto nga takimet informuese ose email mbi organizimin e një takimi informues.</p> <p>Evidenca 3.7 dhe 6.1: Rezultatet e pyetësorit për studentët dhe stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Sondazhet dhe raportet përkatëse analizohen dhe diskutohen nga autoritetet drejtuese dhe personeli akademik duke evidentuar problematikat apo edhe praktikave të mira. Ky proces ndikon në nxitjen e personelit akademik dhe strukturave në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ky angazhim u vu re edhe gjatë takimit të GVJ-së me personelin akademik.</p> <p>Referenca:</p> <p>Shënime gjatë takimeve</p> <p>Evidenca 1.25: VSA Nr. 2, datë 10.01.2025 – Raporti Vjetor 2023–2024</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Gjatë vizitës në universitet dhe vlerësimit të dokumentacionit, GVJ vërejt një përpjekje të strukturuar dhe të vazhdueshme në përmirësimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Studentët gjithashtu janë të përfshirë dhe si aktorë të rëndësishëm në procesin e vlerësimit. U konstatua se rezultatet e vlerësimeve duhet të bëhen publike.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Gjatë takimeve të kryera, GVJ konstatoi se struktura organizative e Universitetit të Arteve është në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 dhe mbështetet në Statutin dhe aktet rregullatore të institucionit. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, funksionon NJSBC në bashkëpunim me Sektorin Mësimor dhe njësitë akademike. Detyrat përfshijnë rishikimin e akteve, zbatimin e standardeve sipas Kodit të Cilësisë, vlerësimin periodik të veprimtarive dhe mbajtjen e databazës së ish-studentëve. GVJ vlerëson se ky organizim mbështet një qasje të strukturuar dhe funksionale për sigurimin e cilësisë në UART.</p> <p>Nga njohja e GVJ me institucionin tri rezultojnë strukturat kryesore në UART që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti; - Sektori Mësimor; - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; <p>Sipas rregullores së funksionimit të NJSBC , struktura përgjegjëse është Zyra Mësimore dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Karrierës dhe Alumnit. Kjo zyrë kryen vlerësimin dhe raportimin periodik në përputhje me standardet e cilësisë. Kjo zyrë raporton tek Zv. Rektori për anën mësimore.</p> <p>Referenca <i>Evidenca 6.4 VSA nr. 24, datë 07/10/2021 – Rregullorja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i> <i>Evidenca 1.5 VSA nr. 15, datë 30/08/2021 – Statuti i UART, Neni 35</i> <i>Evidenca 5.15 VSA nr. 21, datë 07/10/2021 – Rregullore e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të</p>	<p>GVJ gjatë takimit me njësitë përkatëse u njoh me rolin e Njesisë Bazë, që është përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë në Universitetin e Arteve, e mbështetur nga Sektori Mësimor</p>

<p>Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>dhe Sekretaria Mësimore. Pas përfundimit të procesit mësimor, stafi akademik shqyrton problematikat dhe propozon ndryshime për përmirësimin e programeve. Universiteti siguron që studentët të kenë akses në pedagogë të ftuar nga institucione kulturore dhe artistike. Njësia Bazë kryen analiza të detajuara të procesit mësimor, mbështetur nga sygjerimet e stafit dhe anketimet e studentëve, dhe përcjell rezultatet në Departament dhe Dekanat për shqyrtim. Universiteti ka zhvilluar një strategji për sigurimin e cilësisë përmes përgatitjes dhe standardizimit të dokumentacionit, rregulloreve, politikave dhe procedurave, duke siguruar përmbushjen e kërkesave li gjore dhe akademike.</p> <p><i>Shënime gjatë vizitës</i> <i>Evidenca 1.5 VSA nr. 15, datë 30/08/2021, "Statuti i UART", Kreu X, Neni 135 dhe Neni 136</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti është subjekt i akreditimeve periodike institucionale dhe programeve, një praktikë e vendosur prej disa vitesh. Raportet e vlerësimit të brendshëm hartohen si pjesë e procedurës standarde, pasuar nga raportet e vlerësimit të jashtëm.</p> <p>Rezultatet e akreditimeve tregojnë se universiteti ka një performancë të qëndrueshme në lidhje me cilësinë e programeve, që dëshmon masa dhe mjete efikase për Sigurimin e Cilësisë.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>RVB</i> <i>Shënime gjatë vizitës</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Universitetin e Arteve, GVJ u njoh me mekanizmat që institucioni përdor për garantimin e cilësisë së programeve të studimit. Një tregues i rëndësishëm ishte vijimi i studimeve të ciklit të dytë nga të diplomuarit Bachelor, që reflekton efektivitetin e kurrikulave dhe vlerësimin pozitiv të studentëve.</p> <p>Procesi i kontrollit të programeve zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe të strukturuar. Në rastet kur evidentohen mangësi, ndërmerren masa konkrete për përmirësim. Kjo qasje mbështet përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim artistik.</p>




	Referenca: RVB Shënime gjatë vizitës			
Konkluzione	<i>Politikat dhe procedurat në lidhje me Sigurimin e Cilësisë janë prezente dhe në proces konsolidimi. Të tilla praktika janë integruar në punën e përditshme të stafit akademik dhe ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Me zhvillimin e mëtejshëm të programit do të nevojitet edhe hartimi i qasjeve specifike të lidhura me natyrën e programit dhe perspektivën e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<p>Sigurimi i cilësisë së programit është përgjegjësi e Departamentit të Skenografi dhe Koreografi. Departamenti monitoron aktivitetin e përditshëm, kryen analiza periodike dhe iniciativat për ndryshime dhe përmirësime në strukturën dhe përmbajtjen e programit. Analiza e punës vjetore të departamentit dokumentohet përmes raporteve të departamentit.</p> <p>Departamenti dhe Sektori Mësimor zhvillojnë gjithashtu një analizë të sondazheve periodike mbi mësimdhënien.</p> <p>Referenca Shënime nga vizita në Institucion Evidence 1.5 VSA Statutit të UART të Miratuar me Urdhër të MASR Nr. 319, datë 13.09.2021, Kreu X Evidence 3.7 dhe 6.1 Rezultatet e pyetësorit për studentët dhe stafin akademik Evidence 1.25 VSA Nr 2, datë 10.01.2025, Raporti Vjetor 2023-2024</p>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të	Gjatë vizitës së kryer në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion, GVJ konstatoi se Universiteti

<p>përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>i Arteve ka një sistem të qartë dhe të strukturuar për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë akademike, duke e parë këtë si bazë për zhvillimin institucional. Raportet analizojnë rezultatet dhe identifikojnë pika të forta dhe fusha për përmirësim. Rezultatet përcaktohen nga objektivat strategjike dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Procesi përfshin metoda të brendshme dhe të jashtme, përfshirë pyetësorë dhe raportime nga departamentet për performancën akademike dhe aktivitetet artistike. Universiteti nxit angazhimin në projekte artistike dhe promovon kulturën e cilësisë dhe inovacionit.</p> <p>Për të adresuar mangësitë, miratohen masa konkrete për përmirësim, si përditësimi i programeve, zhvillimi profesional i stafit dhe investime në infrastrukturë. Këto masa zbatohen nëpërmjet një koordinimi institucional. Universiteti synon të ruajë dhe forcojë cilësinë akademike dhe artistike në mënyrë të qëndrueshme.</p> <p>Referenca Shënime nga vizita në Institucion Evidence 1.25 Raporti Vjetore</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i</p>	<p>Gjatë takimit të kryer në UART, GVJ u njoh me qasjen e strukturuar dhe shumëanshme të Universitetit të Arteve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës dhe performancës së studentëve. Proceset zhvillohen në nivel institucioni, fakulteti dhe departamenti, duke siguruar monitorim dhe përmirësim të qëndrueshëm. Universiteti përdor metoda të ndryshme, si vlerësimin e studentëve, vëzhgimin gjatë praktikave dhe analizimin e punimeve të diplomës. Sektori Mësimor menaxhon pyetësorët për monitorimin e cilësisë, ndërsa pedagogët e jashtëm kontribuojnë me përvojën e tyre, duke lidhur akademinë me tregun e punës. Kjo siguron një vlerësim të vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës të cilësisë akademike dhe përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale.</p> <p>Referanca Shënime nga vizita në Institucion Evidence 1.25 Raporti Vjetore Evidence 6.5 Foto nga proceset e mësimdhënies në auditor</p>

shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<i>dhe foto nga provimi apo diploma të studentëve</i>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Gjatë takimit, GVJ u njoh si nga raporti ashtu edhe nga bisedat me stafin drejtues me informacionet e vëna në dispozicion. Universiteti i Arteve, si i vetmi institucion publik i arsimit të lartë në fushën e artit dhe kulturës në Shqipëri, synon përgatitjen akademike dhe profesionale të artistëve të rinj dhe zhvillimin e skenës kulturore vendase. Për sigurimin e cilësisë së programeve dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës, përdor metoda të ndryshme vlerësimi. Studentët vlerësojnë kurrikulën, mësimdhënien, kushtet infrastrukturore dhe metodat didaktike, duke identifikuar problematikat e mundshme. Pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm kontribuojnë në përmirësimin e procesit mësimor dhe sjellin përvojë nga industria kulturore për të përshtatur programet me zhvillimet më të fundit. Memorandumet e bashkëpunimit me institucione artistike dhe organizata ofrojnë studentëve mundësi për praktika profesionale dhe përvojë reale në sektorin kulturor. Kjo qasje integruese garanton që Universiteti i Arteve të jetë një qendër akademike dhe krijuese e rëndësishme, në përputhje me standardet më të larta të arsimit të lartë artistik.</p> <p>Referenca</p> <p><i>Tabela Nr. 16 nga tabela 1-24 e programit të studimit BSC në Koreografi.</i></p> <p><i>Të dhënat infrastrukturore për Fakultetin e Artit Skenik.</i></p> <p><i>Evidenca 3.7, Pyetësi për Studentët.</i></p> <p><i>Evidenca 6.1, Pyetësi për Stafin Akademik.</i></p> <p><i>Evidenca 1.29, Memorandume Bashkëpunimi me Institucione Arti ose Kulturë, Studio Prodhimi, Agjenci Kreative, Media dhe Organizata Arti.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vërejti se departamenti dhe strukturat e universitetit të lidhura me Sigurimin e Cilësisë, kryejnë një përpjekje të vazhdueshme për të monitoruar dhe kontrolluar cilësinë e programit. Instrumentat dhe praktikat e përdorura janë duke u konsoliduar.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe në bashkëbisedim me zyrën përkatëse, GVJ u njoh me funksionimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë në Fakultetin e Artit Skenik të Universitetit të Arteve. U evidentua se procesi i sigurimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përfshin aktivisht si aktorët e brendshëm, ashtu edhe ata të jashtëm. Pedagogët e jashtëm bashkëpunojnë ngushtësisht me njësitë përkatëse akademike për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të cilësisë, në përputhje me standardet dhe kriteret institucionale. Gjithashtu, GVJ u informua se studentët kanë rol të drejtpërdrejtë në këtë proces përmes përfaqësimit të tyre dhe pjesëmarrjes në vlerësimet periodike të cilësisë. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të Statutit dhe rregulloreve përkatëse të universitetit, duke garantuar përfaqësimin e strukturave akademike dhe administrative në Komisionin përkatës (KSBC), përfshirë edhe një përfaqësues studentor, siç përcaktohet në nenet 135 dhe 136 të Statutit të Universitetit.</p> <p><i>Evidencë 1.5 – VSA nr. 15, datë 30/08/2021: "Statuti i UART", Neni 35 dhe Neni 123; Neni 135 dhe 136</i> <i>Evidencë 6.4 – VSA nr. 24, datë 07/10/2021: "Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë"</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Sipas Nenit 6 të së njëjtës rregullore (shih më sipër), Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ka disa funksione kyçe, përfshirë: mbledhjen e të dhënave sipas treguesve cilësorë e sasiorë, organizimin e vlerësimeve periodike, përditësimin e dokumentacionit dhe procedurave, përmirësimin e metodologjisë së punës, përpunimin e pyetësorëve dhe vlerësimin e stafit akademik. Gjithashtu, ajo bashkërendon procesin e vlerësimit të brendshëm, harton raportin përkatës çdo dy vite dhe merr pjesë në GVB, duke ruajtur dhe përmirësuar njohuritë përmes trajnimeve.</p> <p>GVJ vërejtë se këto funksione realizohen nga NJSBC, edhe pse jo gjithmonë të mbështetura me dokumentacion të plotë. Megjithatë, proceset janë të vendosura dhe në fazë konsolidimi. Përveç NJSBC, Departamenti dhe Sektori Mësimor mbajnë</p>




	<p>përgjegjësi të rëndësishme në menaxhimin dhe zbatimin e praktikave të sigurimit të cilësisë në nivel programi studimi.</p> <p><i>Evidencë 1.5 – VSA nr. 15, datë 30/08/2021: Statuti i UART, Neni 35</i></p> <p><i>Evidencë 6.4 – VSA nr. 24, datë 07/10/2021: Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i></p> <p><i>Evidencë 5.15 – VSA nr. 21, datë 07/10/2021: Rregullorja e Zyrës Mësimore & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë zhvillon një proces të strukturuar dhe gjithëpërfshirës për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Në këtë proces përfshihen fakulteti, stafi akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentët, të cilët kontribuojnë aktivisht përmes takimeve dhe platformave elektronike. Grupi i vlerësimit të brendshëm, i udhëhequr nga Dekani i Fakultetit të Artit Skenik, siguron një proces transparent dhe të organizuar, duke garantuar respektimin e standardeve akademike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>Evidences 1.9.1 Shkresë Për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në universitet dhe takimeve të ndryshme që u mbajtën, GVJ konstatoi mungesën e çdo shenje diskriminimi, pabarazie apo sjelljeje që nuk i përket etikës akademike. Një ambient gjithëpërfshirës, harmonik dhe respektues u perceptua si ndër studentët ashtu edhe ndër stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk kemi evidencë për angazhimin e drejtpërdrejtë të ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Siç përmendet më sipër, referuar rregullores së NJSBC në rastet kur ka akreditime për herë të parë apo institucionale, thirret një ekspert i jashtëm. Gjithashtu, angazhimi i pedagogëve të jashtëm, të lidhur drejtpërdrejt me tregun e punës jep një feedback të vazhdueshëm për politikën dhe qasjet e institucionit në</p>

mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	drejtimin e SBC. Po ashtu përmes kontakteve me universitete të huaja mundësohet shkëmbimi i eksperiencave të mira dhe marrja e feedback-ut. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm si pjesë e përhershme dhe zyrtare e strukturave të SBC do të mund të sillnin një perspektivë përtej rutinës institucionale.			
Konkluzione	<p><i>Gjatë vëzhgimeve dhe takimeve, GVJ konstatoi një mjedis institucional ku bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të brendshëm në procesin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është i barabartë, i hapur dhe pa përjashtime apo diskriminim. Strukturat dhe procedurat aktuale nxisin pjesëmarrjen aktive të stafit akademik, administrativ dhe studentëve, duke krijuar një bazë solide për reflektim dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në arsimin dhe menaxhimin e programeve.</i></p> <p><i>Megjithatë, GVJ vë në dukje se për të forcuar këtë proces dhe për të garantuar transparencë dhe përfaqësim të plotë, duhet të rritet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm. Pjesëmarrja më e organizuar dhe e vazhdueshme e alumni-t, ekspertëve të jashtëm dhe përfaqësuesve të tregut të punës në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në proceset e tjera të vlerësimit do të pasuronte perspektivat dhe do të afronte universitetin me nevojat e profesionit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në përgjithësi, GVJ konstatoi një nivel transparence dhe komunikimi të mirë brenda universitetit. Një pjesë e mirë e dokumentacionit, rregulloreve dhe informacionit aksesohet lehtësisht online përmes faqes web. UART përdor faqen zyrtare të web- it dhe rrjetet sociale, komunikimin me email dhe takimet informuese në kuadër të këtij qëllimi. http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=292&niveli=85 http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=59&niveli=54
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon	Meqenëse ky është akreditimi i parë për programin e studimit GVJ, nuk gjetën informacione publike mbi rezultatet e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>vlerësimeve periodike. Raportet Vlerësuese të Brendshme (RVB/RVJ) për programet e tjera të studimit, si edhe rezultatet përkatëse të vlerësimeve apo raportet analitike, nuk janë të aksesueshme publikisht. Përtej dokumenteve të vëna në dispozicion dhe RVB-së, mungojnë të dhëna shtesë të hapura për publikun që lidhen me performancën dhe ecurinë e programeve të tjera. Në vijim të procesit të akreditimit, rekomandohet që të bëhen publike raportet e hartuara për këtë program (përfshirë këtë RVJ), si dhe rezultatet e pyetësorëve, duke ofruar analiza të përgjithshme dhe duke shmangur çdo të dhënë që lidhet me individë.</p> <p><i>Evidencë 1.5 – VSA nr. 15, datë 30/08/2021: "Statuti i UART", Neni 76</i> <i>Evidencë 6.4 – VSA nr. 24, datë 07/10/2021: "Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë"</i> <i>Evidencë 5.15 – VSA nr. 21, datë 07/10/2021: "Rregullorja e Zyrës Mësimore & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni"</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Universiteti i Arteve e konsideron vlerësimin si një proces të vazhdueshëm për përmirësimin e cilësisë akademike dhe administrative. Çdo raport, sondazh apo pyetësor shoqërohet me analizë të thelluar dhe plan masash konkrete për të adresuar problemet. Qëllimi është eliminimi i mangësive, forcimi i standardeve dhe përmirësimi i programeve dhe shërbimeve. Në vlerësimin për akreditim, grupet e punës hartojnë masa të qarta dhe të zbatueshme për të identifikuar dhe zgjidhur dobësitë në kohë. Ky proces është i strukturuar dhe synon përmirësimin e vazhdueshëm sipas standardeve më të larta.</p> <p>Gjatë takimit të kryer në institucion, GVJ u njoh me praktikat e ndjekura për vlerësimin e brendshëm, analizat përkatëse dhe masat konkrete të ndërmarra për përmirësim.</p> <p>Shënime nga Institucioni Evidenca 1.25 VSA Nr 2, date 10.01.2025 "Raporti vjetor 2023-2024"</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së</p>	<p>Duhet theksuar se sistemi i Sigurimit të Cilësisë në UA është i ngritur në aspektin formal dhe është relativisht i konsoliduar. Departamenti menaxhon dhe monitoron ecurinë e programit të studimit dhe kryen punë të vazhdueshme në zhvillimin e tij. Procesi i parë i akreditimit (hartimi i RVB she RVJ) është në thelb hapi fillestar në vlerësimin e gjithanshëm të këtij programi, i cili deri tani rezulton të jetë integruar mjaft mirë në</p>

programit të studimit.	ofertën akademike të UA.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Gjatë takimit, GVJ u njoh me organizimin e sektorit Mësimor dhe Kurrikulës (NJSBC), i cili zhvillon sesione për të informuar dhe sensibilizuar stafin dhe studentët për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. GVJ u njoh me aktivitetet të cilat përfshijnë takimet e zhvilluara për ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe zhvillimin e anketave në lidhje dhe me programin e studimit "Skenografi dhe Kostumografi", me vlerësime të mbështetura në dokumentat konkrete.</p> <p><i>Evidence 6.1 Të dhëna nga pyetësorët e stafit akademik në FAS</i></p> <p><i>Evidencës 6.3 Foto nga takimet informuese ose email mbi organizimin e nje takimi informues</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Politikat dhe procedurat për Sigurimin e Cilësisë janë të vendosura dhe në proces të vazhdueshëm konsolidimi, duke u bërë pjesë e praktikës së përditshme të stafit akademik. Ato synojnë rritjen e cilësisë së programeve të studimit përmes monitorimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm. GVJ konstatoi angazhim të qëndrueshëm nga strukturat përkatëse të institucionit në mbështetje të një klime bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse, ku aktorë të ndryshëm kontribuojnë në zhvillimin e një arsimit cilësor. Megjithatë, vlerësohet si e nevojshme zhvillimi i qasjeve më specifike dhe të përshtatura sipas karakterit të secilit program studimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Skenografi dhe Kostumografi.” të ofruar nga “Universiteti I Arteve”

Pikat e forta:

1. Prurjet e studenteve janë si nga gjimnazet e përgjithshme si nga shkollat artistike

Prurjet e studentëve në programet e studimit të Skenografisë dhe Kostumografisë janë të karakterizuara nga një miks i kandidatëve që vijnë si nga gjimnazet e përgjithshme, ashtu edhe nga shkollat artistike. Ky diversitet në origjinën e studentëve ka disa aspekte të rëndësishme që ndikojnë në dinamikën e mësimit dhe zhvillimin e programit, duke pasur përparësitë dhe sfidat e veta. Kz aspekt është një pikë e fortë e programit, gjë që favorizon ecurinë e tij, dhe prurjen me studentë.

2. Programi i Studimit Bachelor në Skenografi dhe Kostumografi, me një histori që kalon mbi 50 vjet. Ky program, i themeluar nga profesionistë të shquar të fushës në vitet '60, ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në formimin e brezave të rinj artistësh dhe ka kontribuar në zhvillimin e skenografisë dhe kostumografisë në Shqipëri.

Pika të dobëta:

1. Shkëmbimi dhe mundësitë e mobilitetit Erasmus+

Një nga kufizimet e aktuale në programin e studimit Bachelor në: “Skenografisë-Kostumografi” është mungesa e mundësive të shkëmbimit dhe mobilitetit ndërkombëtar përmes programit Erasmus+. Mungesa e mundësive shkëmbimi mund të kufizojë zhvillimin e studentëve, duke i privuar ata nga mundësia për të mësuar në një kontekst ndërkombëtar dhe për të krijuar lidhje me profesionistë dhe institucione të tjera. (Standardi III.1, kriteri 6)

Rekomandime:

1. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) rekomandon një rishikim të strukturës së kurrikulës me qëllim përmirësimin e balancës midis disa lëndëve ekzistuese dhe atyre me përmbajtje profesionalo-artistike. Duke qenë se programi ka një profil të qartë profesional dhe artistik, vlerësohet e domosdoshme që t’i vihet theks i veçantë lëndëve që zhvillojnë drejtpërdrejt kompetencat e synuara të programit. Për këtë arsye, GVJ rekomandon përfshirjen e lëndëve të tjera me karakter teorik, artistik, bashkëkohor dhe profesional, të cilat kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në formimin artistik dhe teknik të studentëve dhe rrisin koherencën e përgjithshme të kurrikulës me qëllimet e saj formuese.
2. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) rekomandon që programi i studimit në Skenografi dhe Kostumografi të ndërmarrë hapa konkretë për të krijuar mundësi

shkëmbimi dhe mobiliteti ndërkombëtar përmes përfshirjes në programin Erasmus+ dhe iniciativave të ngjashme. Përfshirja në mobilitetin ndërkombëtar do të përbënte një vlerë të shtuar për programin, duke kontribuar në rritjen e cilësisë akademike, ndërkombëtarizimin e institucionit dhe përgatitjen më të plotë të studentëve për tregun evropian të punës në fushën artistike dhe kulturore.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Scenography and Costume Design" provided by the Higher Education Institution "University of Arts"

Strengths:

1. Diverse Student Intake from General and Art Schools

The student intake in the Scenography and Costume Design programs is characterized by a mix of candidates coming from both general high schools and specialized art schools. This diversity in student backgrounds brings several important aspects that influence the learning dynamics and program development, each with its own advantages and challenges. This feature is considered a strong point of the program, as it enhances its progress and attracts a broader range of students.

2. A Study Program with Over 50 Years of History

The Bachelor Program in Scenography and Costume Design, with a history spanning over 50 years, was established by distinguished professionals in the field during the 1960s. It has had a significant impact on the education of generations of young artists and has contributed to the development of scenography and costume design in Albania.

Weaknesses:

1. Limited Erasmus+ Exchange and Mobility Opportunities

One of the current limitations of the Scenography and Costume Design study program is the lack of international exchange and mobility opportunities through the Erasmus+ program. This lack of exchange options may hinder student development by depriving them of the chance to learn in an international context and to establish connections with professionals and institutions abroad. **(Standard III.1, Criterion 6)**

Recommendations:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



1. Curriculum Review for Better Balance

The External Evaluation Group (EEG) recommends a review of the curriculum structure to improve the balance between existing courses and those with a more professional and artistic focus. Given that the program has a clear professional and artistic profile, it is deemed essential to place special emphasis on courses that directly develop the program's targeted competencies. Therefore, the EEG suggests including additional theoretical, artistic, contemporary, and professional courses that directly contribute to the artistic and technical formation of students and enhance the overall coherence of the curriculum with its educational objectives.

2. Enhancing International Mobility

The External Evaluation Group (EEG) recommends that the Scenography and Costume Design study program take concrete steps to create international exchange and mobility opportunities through participation in the Erasmus+ program and similar initiatives. Engagement in international mobility would add significant value to the program by contributing to academic quality, the internationalization of the institution, and better preparation of students for the European labor market in the artistic and cultural fields.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X




